
Standarde dhe Udhëzime për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë

Shoqata Europiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë ENQA
Helsinki, Finlandë 2005

Përkthyer dhe përshtatur në shqip nga
Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë

ribotim
Dhjetor 2007

Parathënie

Në Komunikatën e Berlinit në 19.09.2003, Ministrat e shteteve nënshkruese të Procesit të Bolonjës ftuan Shoqatën Europiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA-n), që, përmes anëtarëve të saj, si dhe në bashkëpunim me EUA, EURASHE dhe ESIB, të zhvillonin “një tërësi të miratuar standardesh, procedurash dhe udhëzimesh për sigurimin e cilësisë” dhe “të gjenin rrugë dhe mekanizma për të siguruar një sistem vlerësimi të jashtëm të përshtatshëm për agjencitë dhe institucionet e Sigurimit të Cilësisë ose të akreditimit dhe të raportin, përmes Grupit të Vazhdimësisë (Follow Up Group) të Bolonjës në Takimin e Ministrave në 2005”. Ministrat, i kërkuan gjithashtu ENQA-s, të marrë parasysht edhe “përvojën e Shoqatave dhe Rrjeteve të tjera të Sigurimit të Cilësisë”.

Ky raport është një përgjigje ndaj kësaj kërkesë dhe del e botohet me miratimin e të gjitha organizatave të përmendura në atë seksion të komunikatës. Arritja e një mirëkuptimi të tillë të përbashkët është një kontribut i shpirtit të bashkëpunimit dhe respektit të dyanshëm që ka karakterizuar diskutimet midis palëve të përfshira në proces. Gjithashtu dua t'i shpreh falenderimet e mia EUA, EURASHE dhe ESIB së bashku me agjencitë anëtare të ENQA-s për kontributin konstruktiv dhe shumë të vlefshëm që dhanë në këtë proces.

Ky raport i drejtohet Ministrave Europianë për Arsimin. Gjithsesi ne presim një shpërndarje më të gjerë të Raportit tek ata që kanë interes për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë. Ne shpresojmë që këta lexues ta gjejnë këtë raport të dobishëm dhe frymëzues.

Duhet të theksohet që Raporti është vetëm hapi i parë në rrugën e gjatë dhe të vështirë të themelimit të një rrjeti të gjerë, të përhapur vlerash, pritjesh dhe të praktikës së mirë në lidhje me cilësinë dhe sigurimin e saj, nga Institucionet dhe agjencitë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë (HEAL). Ajo çka është vënë në lëvizje nga Mandati i Berlinit nevojitet të zhvillohet më tej nëse kërkohet që ai të sigurojë funksionimin e plotë të dimensionit Europian për Sigurimin e Cilësisë në HEAL. Nëse kjo do të arrihet, atëherë do të arrihen edhe shumë nga ambicjet e Procesit të Bolonjës. Të gjithë ata që kanë marrë pjesë deri tani në këtë punë, presin me padurim të kontribuojnë edhe më tej në suksesin e kësaj orvatjeje.

Christian Thune

President i ENQA-s

Shkurt 2005

Shënim i APAAL: Ky dokument, u paraqit në Mbledhjen e Ministrave të Arsimit në Bergen, Norvegji në Maj 2005 dhe u miratua si i tillë për t'u zbatuar.

Përmbajtja

Përmbledhje	4
1. - Konteksti, Qëllimet dhe Parimet	10
2. - Standardet dhe Udhëzimet Europiane	12
Background i standardeve dhe udhëzimeve	13
Hyrje për pjesët 1 dhe 2: Standardet dhe Udhëzimet Europiane për Sigurimin e Brendshëm dhe të Jashtëm të Cilësisë në Arsimin e Lartë	14
Pjesa 1: Standardet dhe Udhëzimet Europiane për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në Institucionet e Arsimit të Lartë	17
Pjesa 2 : Standardet dhe udhëzimet Europiane për sigurimin e Jashtëm të Cilësisë në Arsimin e Lartë	22
Hyrje për pjesën 3 : Standardet dhe Udhëzimet Europiane për agjencitë e sigurimit të jashtëm të cilësisë	26
Pjesa 3 : Standardet dhe udhëzimet Europiane për agjencitë e sigurimit të jashtëm të cilësisë	27
3. Sistemi i Vlerësimit të Jashtëm për Agjencitë e Sigurimit të Cilësisë	31
Konteksti ndërkombëtar	32
Rivlerësimet ciklike të agjencive	33
Regjistri i Agjencive të Sigurimit të Jashtëm të Cilësisë që veprojnë në Europë	35
Forum i Konsultativ Europian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë	38
4. Perspektivat dhe Sfidat në të Ardhmen	39
Aneks: Vlerësimi ciklik i agjencive të sigurimit të cilësisë - një model teorik	41

Përmbledhje

Ky raport është hartuar nga Shoqata Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA)¹, përmes anëtarëve të saj, duke u këshilluar dhe në bashkëpunim me EUA, ESIB dhe EURASHE dhe në diskutim me network-e të ndryshme me të cilat ajo ka lidhje. Ai përbën përgjigjen ndaj mandatit të dyfishtë që ju dha ENQA-s në Komunikatën e Berlinit, në Shtator 2003, për të zhvilluar “një tërësi të miratuar standardesh, procedurash dhe udhëzimesh për Sigurimin e Cilësisë” dhe “për të gjetur mënyrat e rrugët për të siguruar një sistem vlerësimi të jashtëm të përshtatshëm për agjencitë apo institucionet e Sigurimit të Cilësisë dhe/ose Akreditimit.

Raporti përbëhet nga katër kapituj. Pas kapitullit të prezantimit për kontekstin, qëllimet dhe parimet, vazhdojnë kapitujt mbi standardet dhe udhëzimet për sigurimin e cilësisë²; një sistem vlerësimi i jashtëm për agjencitë e sigurimit të cilësisë; dhe perspektivat e sfidat në të ardhmen.

Rezultatet kryesore dhe rekomandimet e raportit janë:

- Standardet Evropiane për sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë, për IAL si dhe për agjencitë e sigurimit të jashtëm të cilësisë.
- Agjencitë evropiane për sigurimin e cilësisë pritet t'i nënshtrohen vetë një vlerësimi ciklik brenda 5 viteve.
- Do të vihet theksi në shprehjen e interesit, dëshirës (vullnetit, nuk është i detyrueshëm), ku vlerësimet të mund të kryhen edhe në nivel kombëtar, aty ku është e mundur.
- Do të krijohet një regjistër evropian i agjencive të sigurimit të cilësisë.
- Një komitet për regjistrin evropian do të veprojë si një organizëm pikëhyrje (pikëkontrolli) për përfshirjen e agjencive në regjistër.
- Krijimi i një Forumi Konsultativ Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Kur rekomandimet të vihen në jetë:

- Qëndrueshmëria e sigurimit të cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (HEAL) do të përmirësohet përmes përdorimit të standardeve dhe udhëzimeve të miratuara.
- Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) dhe Agjencitë e Sigurimit të Cilësisë (ASC) në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (HEAL) do të jenë të afta të përdorin

pika reference të përbashkëta për sigurimin e cilësisë.

- Regjistri do ta bëjë më të lehtë identifikimin e Agjencive profesionale të besueshme.
- Procedurat për njohjen e kualifikimeve do të përforcohen e konsolidohen.
- Besueshmëria në aktivitetin e Agjencive të Sigurimit të Cilësisë dhe të Akreditimit të Arsimit të Lartë do të rritet.
- Shkëmbimi i pikëpamjeve dhe përvojave midis agjencive dhe aktorëve të tjerë kyç (duke përfshirë IAL-të, studentët dhe përfaqësuesit e tregut të punës), do të përmirësohet përmes punës së Forumit Konsultativ Europian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë.
- Besimi i dyanshëm midis institucioneve dhe agjencive do të rritet.
- Do të mundësohet më tej lëvizja drejt njohjes së dyanshme.

Listë përmbledhëse e Standardeve Europiane për Sigurimin e Cilësisë)

Kjo listë përmbledhëse e Standardeve Europiane për Sigurimin e Cilësisë në AL është marrë nga kapitulli 2 i raportit dhe është vendosur këtu për lehtësi reference. Ajo nuk përfshin udhëzimet shoqëruese. Standardet janë grupuar në tre pjesë që mbulojnë përkatësisht, Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC) në IAL, Sigurimin e Jashtëm të Cilësisë (SJC) në AL dhe Sigurimin e Cilësisë të Agjencive të Sigurimit të Jashtëm të Cilësisë.

Pjesa 1: Standardet dhe Udhëzimet Europiane për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në Institucionet e Arsimit të Lartë.

- 1.1 Politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë:** IAL duhet të kenë politika dhe procedura të bashkërenduara për sigurimin e cilësisë dhe standarde për programet dhe diplomat që lëshojnë. Ato duhet të angazhohen shprehimisht për zhvillimin e një kulture e cila njih rëndësinë e cilësisë dhe Sigurimin e Cilësisë në punën e tyre. Për të arritur këtë institucionet duhet të zhvillojnë dhe të vënë në jetë një strategji për përmirësim në vazhdimësi të cilësisë. Strategjia, politikat dhe procedurat duhet të kenë një status zyrtar dhe të jenë të disponueshme publikisht. Ato gjithashtu duhet të parashikojnë rolin e studentëve dhe aktorëve të tjerë.
- 1.2 Miratimi, monitorimi dhe vlerësimi periodik i programeve dhe diplomave:** IAL duhet të kenë mekanizma zyrtarë për miratimin, vlerësimin

periodik dhe monitorimin e programeve dhe diplomave të tyre.

- 1.3 Vlerësimi i studentëve:** Studentët duhet të vlerësohen duke përdorur kritere të publikuara, rregulla dhe procedura të cilat zbatohen në mënyrë të vazhdueshme e të përhershme.
- 1.4 Sigurimi i Cilësisë i stafit mësimdhënës:** IAL duhet të kenë mënyra për t'u siguruar se stafi i përfshirë në mësimdhënien e studentëve është i kualifikuar dhe i aftë. Ata duhet të jenë të disponueshëm ndaj atyre që ndërmarrin vlerësimet e jashtme dhe komenteve në raporte.
- 1.5 Burimet për mësimdhënie dhe mbështetja e studentëve:** IAL duhet të sigurohen që burimet e disponueshme për të mbështetur mësimnxënien e studentit, janë të përshtatshme dhe të përshtatura për çdo program të ofruar.
- 1.6 Sistemet e informacionit:** IAL duhet të sigurojnë mbledhjen, analizimin dhe përdorimin e të gjithë informacionit të përshtatshëm për administrimin efektiv të programeve të tyre të studimit dhe aktiviteteve të tjera.
- 1.7 Informimi publik:** IAL duhet të publikojnë rregullisht informacion të përditësuar, objektiv dhe të paanshëm, si sasi orë ashtu edhe cilësor, për programet dhe diplomat që ato ofrojnë.

Pjesa 2: Standardet Europiane për Sigurimin e Jashtëm të Cilësisë në Arsimin e Lartë

- 2.1 Përdorimi i procedurave për SBC:** Procedurat për SJC duhet të marrin parasysh efektivitetin e proceseve të SBC të përshkruara në pjesën 1 të Standardeve dhe Udhëzimeve Europiane.
- 2.2 Zhvillimi i proceseve të SJC:** Qëllimet dhe objektivat e proceseve të Sigurimit të Cilësisë duhet të përcaktohen përpara se të zhvillohen vetë proceset, nga të gjithë ata që janë përgjegjës (duke përfshirë edhe IAL), dhe duhet të publikohen, të shoqëruara me një përshkrim për procedurën e përdorur.
- 2.3 Kriteret për vendimmarrje:** Çdo vendim zyrtar i marrë si rezultat i një aktiviteti për SJC duhet të bazohet mbi kritere të qarta të publikuara, që aplikohen në vazhdimësi.
- 2.4 Proceset të përshtatura me qëllimin (fit for purpose):** Të gjitha proceset për SC duhet të hartohen në mënyrë specifike për të siguruar përshtatshmërinë e tyre për arritjen e qëllimeve dhe objektivave të vendosura.
- 2.5 Raportimi:** Raportet duhet të publikohen dhe duhet të jenë në formë të shkruar, me një stil të qartë dhe lehtësisht të kuptueshëm nga rrethi i menduar i lexuesve. Çdo vendim, miratim dhe rekomandim që përmbajnë raportet duhet të jetë i

lehtë për t'u kuptuar nga lexuesi.

- 2.6 Procedurat e vazhdimësisë (Follow-up):** Proceset e SC të cilët kërkojnë një plan veprimi pasues, duhet të kenë procedura vazhduese të paracaktuara, të cilat zbatohen në vazhdimësi.
- 2.7 Vlerësimet periodike:** SJC i IAL dhe/ose programeve duhet të ndërmerret në baza ciklike, periodike. Kohëzgjatja e ciklit dhe procedurave të vlerësimit duhet të përcaktohet qartë dhe të publikohet paraprakisht.
- 2.8 Analiza Përgjithësuese:** Agjencitë e Sigurimit të Cilësisë duhet të nxjerrin kohë pas kohe raporte përmbledhëse që përshkruajnë dhe analizojnë gjetjet e përgjithshme të rivlerësimeve, vlerësimeve etj.

Pjesa 3: Standardet Europiane për Agjencitë e Sigurimit të Jashtëm të Cilësisë (SJC)

- 3.1 Përdorimi i procedurave të SJC për AL:** Agjencitë e SJC duhet të marrin parasysh ekzistencën dhe efektivitetin e proceseve të SJC të përshkruara në Pjesën 2 të Standardeve dhe Udhëzimeve Europiane.
- 3.2 Statusi zyrtar:** Agjencitë duhet të jenë të njohura zyrtarisht nga autoritetet publike kompetente në HEAL si agjenci që kanë përgjegjësi për SJC dhe duhet të jenë të ngritura mbi baza të qarta ligjore. Ato duhet të jenë në përputhje me kërkesat legjislative brenda të cilave ato veprojnë.
- 3.3 Veprimtaria:** Agjencitë duhet të ndërmarrin aktivitete për SJC të institucioneve apo programeve mbi baza të rregullta.
- 3.4 Burimet:** Agjencitë duhet të kenë burime të mjaftueshme dhe të përshtatshme, si njerëzore ashtu dhe financiare që bëjnë të mundur organizimin dhe ndjekjen e proceseve të SJC në mënyrë të dobishme dhe efikase, shoqëruar me masat e duhura për zhvillimin e proceseve dhe procedurave të tyre.
- 3.5 Misioni:** Agjencitë duhet të kenë synime dhe objektiva të shprehura dhe të qarta në punën e tyre, të përfshira në një deklaram të disponueshëm publikisht.
- 3.6 Pavarësia:** Agjencitë duhet të jenë të pavarura deri në atë masë që ato të jenë autonome në veprimtarinë e tyre dhe që përfundimet dhe rekomandimet që ato nxjerrin në raportet e tyre, të mos ndikohen nga palë të treta të tilla si: IAL, ministritë apo aktorë të tjerë të interesuar.
- 3.7 Kriteret për SJC dhe proceset e përdorura nga Agjencitë:** Proceset, kriteret dhe procedurat e përdorura nga Agjencia duhet të jenë të parapërcaktuara dhe në dispozicion të publikut.
Këto procese normalisht duhet të përfshijnë:

- Një vetëvlerësim ose procedurë ekuivalente nga subjekti në procesin e Sigurimit të Cilësisë
- Një vlerësim të jashtëm nga një grup ekspertësh, duke përfshirë, si të përshtatshëm edhe a) anëtar student(ë) dhe vizitat në vend ashtu si vendosen nga agjencia
- Publikimin e një raporti, duke përfshirë vendime, rekomandime ose rezultate të tjera zyrtare
- Një procedurë vazhdimësie për të rishikuar veprimet e marra nga subjekti në procesin e sigurimit të cilësisë në dritën e rekomandimeve që përmbahen në raport.

3.8 Procedurat e vetëpërgjegjësisë: Agjencitë duhet të vendosin procedura për vetëpërgjegjshmërinë e tyre.

1. Konteksti, Qëllimet dhe Parimet

Në Komunikatën e Berlinit të 19 shtatorit 2003, Ministrat e Shteteve nënshkruese të Procesit të Bolonjës, ftuan ENQA-n që “përmes anëtarëve të saj, në bashkëpunim me EUA, EURASHE dhe ESIB”, të zhvillojnë “një tërësi të miratuar standardesh, procedurash dhe udhëzimesh për Sigurimin e Cilësisë” dhe “të gjenin mënyra për sigurimin e një Sistemi Vlerësimi të Jashtëm për Sigurimin e Cilësisë dhe/ose Akreditimin e Agjencive ose Institucioneve të Sigurimit të Cilësisë, dhe Raportimin më pas përmes Grupit të Vazhdimësisë të Bolonjës, në Mbledhjen e Ministrave në 2005-ën. Ministrat gjithashtu i kërkuan ENQA-s të merrte parasysh ekspertizën e shoqatave dhe rrjeteve të tjera të Sigurimit të Cilësisë.

ENQA mirëpriti këtë mundësi për të dhënë kontribut më të madh në zhvillimin e dimensionit European për Sigurimin e Cilësisë dhe në këtë mënyrë për të nxitur më tej qëllimet e Procesit të Bolonjës.

Puna ka përfshirë organizata dhe grupe interesi të ndryshme. Së pari, anëtarët e ENQA-s janë përfshirë gjerësisht në këtë proces. Anëtarët kanë marrë pjesë në grupet e punës dhe draft-raportet kanë qenë elemente të rëndësishme në axhendën e Asambleve të Përgjithshme të ENQA-s në Qershor dhe Shtator 2004. Së dyti, Shoqata Europiane e Universiteteve (European University Association-EUA), Shoqata Europiane për Institucionet në Arsimin e Lartë (European Association of Institutions in Higher Education - EURASHE), Bashkimet Kombëtare të Studentëve në Europë (National Unions of Students in Europe - ESIB) dhe Komisioni European (European Commission – EC) kanë marrë pjesë me takime të rregullta në ‘Grupin E4’. Së treti, kontaktet dhe kontributet nga rrjete të tjerë, si Konsorciumi European për Akreditimin (ECA) dhe Rrjeti i Europës Qendrore dhe Lindore i Agjencive të Sigurimit të Cilësisë (CEE Network) kanë qenë të çmuara në procesin e draftimit. Së fundi, ENQA dhe partnerët e saj kanë shfrytëzuar mirë kontaktet dhe përvojat e tyre individuale kombëtare dhe, në këtë mënyrë, siguruan që këtij procesi t’i shtohen edhe perspektiva të ngjashme ndërkombëtare.

Sigurimi i Cilësisë në AL nuk është në asnjë mënyrë një çështje vetëm Europiane. Në të gjithë botën ka një rritje të interesit për cilësinë dhe standardet, duke reflektuar si zhvillimin e shpejtë të AL, ashtu dhe rritjen e kostos së tij në shpenzimet publike dhe private. Nëse Europa duhet të arrijë ashtu siç duhet aspiratat e saj për t’u bërë ekonomia më e qendrueshme dhe më dinamike në botë (Strategjia e Lisbonës), atëherë dhe Arsimi i Lartë European do nevojitet të tregojë se e merr seriozisht cilësinë

e programeve dhe diplomave të tij dhe është i gatshëm për të vendosur mjetet e sigurimit dhe demonstrimin e kësaj cilësie. Iniciativat dhe kërkesat, të cilat lindin si brenda ashtu dhe jashtë Europës përpara këtij ndërkombëtarizimi të AL, kërkojnë një përgjigje. Përkushtimi i të gjithë atyre të përfshirë në paraqitjen e këtyre propozimeve të parathëna, krijon kushtet për përmbushjen e një Dimensioni të vërtetë European në Sigurimin e Cilësisë, përmes të cilit fuqizohet dhe atraktiviteti i ofertës të AL në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë.

Propozimet që përmban ky raport mbështeten mbi një numër parimesh të cilat janë të përshkruara më në detaje, në 2 kapitujt të cilët mbulojnë dy pjesët e Mandatit të Berlinit. Megjithatë, disa parime themelore që duhet të përshkruajë të gjithë punën janë:

- Interesi që kanë studentët si dhe punëdhënësit e shoqërisë më gjerësisht për një Arsim të Lartë cilësor;
- Rëndësia qendrore e autonomisë institucionale duke pranuar se kjo e fundit sjell me vete edhe përgjegjshmëri më të lartë;
- Nevoja që Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë t'i përshtatet qëllimit të tij dhe të vendosë vetëm një ngarkesë të nevojshme dhe të përshtatshme mbi institucionet për arritjen e objektivave të tij.

HEAL me të 40 shtetet e saj, karakterizohet nga diversiteti i sistemeve politike, sistemeve të AL, traditave arsimore dhe social-kulturore, gjuhëve, aspiratave dhe pritshmërive. Kjo bën më të vështirë përafrimin unik e njëbllokësh të cilësisë, standardeve dhe sigurimit të cilësisë në një Arsim të Lartë. Në dritën e kësaj ndryshueshmërie dhe shumëllojshmërie, përgjithësisht e njohur si një nga lavditet e Europës, raporti përballlet me një përafrim të kufizuar normativ dhe tepër të formuluar me standardet. Për këtë arsye, si për standardet ashtu dhe për udhëzimet, raporti preferon parimet e përgjithshme mbi kërkesat specifike. Kjo bëhet sepse besohet se ky afrim duhet të shërbejë më tepër si udhëzues në miratimin e gjerë në radhë të parë dhe të sigurojë një bazë më të fuqishme për bashkimin e Komuniteteve të AL-ve të ndryshme në HEAL. Standardet e përgjithshme duhet të gjejnë një rezonancë të gjithanshme në nivel kombëtar³ të shumicës së shteteve nënshkruese. Megjithatë, një pasojë e parimeve të përgjithshme është që standardet e udhëzimet përqendrohen më tepër në ato që duhet të bëhen sesa në ato që do të arrihen. Pra raporti nuk përfshin çështjet procedurale, por i ka dhënë prioritet standardeve dhe udhëzimeve, sidomos në kapitullin 2.

Së fundi, duhet të kuptohet që arritja e marrëveshjes për këtë raport nuk është e njëjta gjë me arritjen e synimeve të Bolonjës për një Hapësirë të Sigurimit të Cilësisë në HEAL. Ka ende shumë punë për të bërë në të ardhmen, për të vënë në jetë rekomandimet e raportit dhe për të krijuar Kulturën e vetëkuptuar të Cilësisë si në IAL ashtu edhe në vetë Agjencitë e Sigurimit të Cilësisë.

2. Standardet dhe Udhëzimet Europiane

Mandati i Ministrave për të zhvilluar “një tërësi të miratuar standardesh, procedurash dhe udhëzimesh” ngriti një numër pyetjesh të rëndësishme. ‘Sigurimi i Cilësisë’ është një term i përgjithshëm në AL i cili çon në shumë interpretime: Nuk është e mundur të përdoret një përkufizim për të mbuluar të gjitha rastet. Në mënyrë të ngjashme, fjala ‘standard’ përdoret në një mori mënyrash nëpër Europë, që nga shprehjet e kërkesave normative të përcaktuara ngushtësisht, deri në përshkrime të përgjithësuara të praktikës së mirë. Fjalët gjithashtu kanë shumë kuptime të ndryshme në kontekstet lokale të sistemeve kombëtare të AL.

Për më tepër, vetë procesi i hartimit ka bërë të qartë se, brenda vetë komunitetit të Sigurimit të Cilësisë, ka disa ndryshime thelbësore pikëpamjesh mbi lidhjen e përshtatshme që duhet të vendoset midis IAL dhe vlerësuesve të jashtëm. Disa nga agjencitë që akreditojnë programet ose institucionet, kanë pikëpamjen se Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë është më tepër një çështje e ‘mbrojtjes së konsumatorëve’, e që kërkon vendosjen e një distancë e qartë midis Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë dhe IAL-ve, punën e të cilëve vlerësojnë. Ndërsa Agjenci të tjera shohin si qëllim parësor të SJC këshillimin dhe ndjekjen në proces drejt përmirësimit dhe përmbushjes së standardeve dhe arritjen e cilësisë në programet e studimit dhe kualifikimeve që i shoqërojnë ato. Në rastin e fundit kërkohet një lidhje e ngushtë midis vlerësuesve dhe të vlerësuarit. Të tjerë akoma, duan të marrin një pozicion diku midis këtyre të dyve, duke kërkuar të ekuilibrojnë përgjegjshmërinë dhe përmirësimin.

Nuk janë vetëm Agjencitë e Sigurimit të Cilësisë që kanë mendime të ndryshme në këto çështje. Interesat e IAL-ve dhe Trupave Përfaqësues të Studentëve nuk janë gjithmonë të njëjta; i pari kërkon një nivel më të lartë autonomie me një minimum rregullash ose vlerësimesh të jashtme (edhe këtë në nivel institucional), të fundit duan që institucionet të jenë publikisht përgjegjës përmes inspektimeve të shpeshta në nivel programi ose kualifikimi.

Përfundimisht, standardet dhe udhëzimet lidhen vetëm me tre ciklet e AL të përshkruara në Deklaratën e Bolonjës dhe nuk kanë si qëllim të mbulojnë të gjithë hapësirën e kërkimeve ose administrimit në përgjithshëm institucional.

Background-i i standardeve dhe udhëzimeve

Ky seksion i raportit përmban një set standardesh dhe udhëzimesh të propozuara për SC në HEAL. Standardet dhe udhëzimet janë hartuar për t'u aplikuar në të gjitha IAL-të dhe Agjencitë e Sigurimit të Cilësisë në Europë, pavarësisht nga struktura e tyre, funksioni dhe madhësia, dhe sistemi kombëtar në të cilin janë vendosur e veprojnë. Siç është përmendur më lart, nuk është konsideruar e përshtatshme të përfshihen detaje 'procedurale' në rekomandimet e këtij kapitulli të raportit, meqenëse procedurat institucionale dhe ato të agjencive janë një pjesë e rëndësishme e autonomisë së tyre. Bashkëpunimi do të jetë për IAL-të dhe Agjencitë brenda vetë kontekstit të tyre individual, për të vendosur pasojat procedurale të adaptimit të standardeve që përmban ky raport.

Pikësëpari, standardet dhe udhëzimet vërtetojnë shpirtin e "Deklaratës së Graz-it / Korrik 2003" të EUA e cila shpalli se "qëllimi i Hapësirës Europiane të Sigurimit të Cilësisë është të promovojë besimin e dyanshëm dhe të përmirësojë transparencën, ndërsa respekton diversitetin e konteksteve kombëtare dhe hapësirat e subjekteve (IAL dhe Agjenci)". Në harmoni me Deklaratën e Graz-it, Standardet dhe Udhëzimet që përmban ky raport njohin supremacinë e sistemeve kombëtare të AL, rëndësinë e autonomisë së institucioneve dhe agjencive brenda këtyre sistemeve kombëtare, dhe kërkesat e posaçme të subjekteve të ndryshme akademike. Veç kësaj, standardet dhe udhëzimet i detyrohen shumë eksperiencës së mbledhur gjatë projektit pilot të koordinuar nga ENQA "Projekti i Vlerësimit European Ndërkombësh" (TEEP), i cili shqyrtoi, në tre disiplina, ndërlikimet e procesit European Ndërkombësh të Vlerësimit të Cilësisë.

Standardet dhe udhëzimet gjithashtu marrin parasysh studimin për konvergjenat për cilësinë (Quality Convergence Study) të publikuara nga ENQA në Mars 2005, e cila shqyrtonte arsyet e përqaesjeve të ndryshme kombëtare për SJC dhe detyrimin për konvergjim në këtë drejtim. Për më tepër ato reflektojnë formulimin e Ministrave në Komunikatën e Berlinit që "në përputhje me parimin e autonomisë institucionale, përgjegjësia parësore për SC në AL i përket vetë çdo institucioni dhe kjo përbën bazën për përgjegjshmëri reale të sistemit akademik brenda strukturës kombëtare të cilësisë". Për pasojë, në këto standarde dhe udhëzime, është kërkuar të arrihet një drejtpeshim i përshtatshëm midis krijimit dhe zhvillimit të kulturës së brendshme të cilësisë dhe rolit që mund të luajnë procedurat për SJC.

Përveç sa më sipër, standardet dhe udhëzimet kanë përfituar gjithashtu nga "Kodi i Praktikës së Mirë", publikuar në Dhjetor 2004 nga ECA dhe perspektiva të tjera të përfshira në "Qendrimin mbi standardet, procedurat dhe udhëzimet e miratuara në nivel evropian" të ESIB, (Prill 2004) dhe "Qendrimin për vlerësimin e jashtëm të agjencive të SC dhe të akreditimit" (Prill 2004), "Vendosja e politikës së Sigurimit të

Cilësisë (SC) në kontekstin e Komunikatës së Berlinit” EUA (Prill 2004) dhe “Qendrimi Politik mbi procesin e Bolonjës”, EURASHE, (Qershor 2004). Së fundi, është përfshirë edhe një perspektivë ndërkombëtare duke krahasuar standardet e SJC me “ Udhëzimet për Praktikën e Mirë” të vëna në jetë nga rrjeti ndërkombëtar INQAAHE.

Hyrje për Pjesët 1 dhe 2: Standardet Europiane dhe Udhëzimet për Sigurimin e Brendshëm dhe të Jashtëm të cilësisë

Standardet dhe udhëzimet për sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë, në vijim janë zhvilluar për t’u përdorur nga IAL-të dhe agjencitë e sigurimit të cilësisë që punojnë në HEAL dhe mbulojnë hapësirat kyçe lidhur me cilësinë dhe standardet.

Qëllimi i këtyre standardeve dhe udhëzimeve është të sigurojnë një burim ndihme dhe drejtimi për IAL-të, për zhvillimin e sistemeve të tyre të sigurimit të cilësisë, për agjencitë që zhvillojnë SJC, dhe të kontribuojnë për një kuadër të përbashkët reference, i cili mund të përdoret njëlloj nga institucionet dhe agjencitë. Këto standarde dhe udhëzime nuk kanë për qëllim të diktojnë praktikën ose të interpretohen si të detyrueshme ose të pandryshueshme.

Në disa vende të HEAL Ministria e Arsimit ose një organizëm ekuivalent ka përgjegjësinë për disa nga hapësirat e mbuluara nga standardet dhe udhëzimet. Në këto raste, ajo ministri apo organizëm duhet të sigurojë vendosjen e mekanizmave të përshtatshëm për SC dhe ato duhet të jenë subjekt i vlerësimeve të pavarura.

Parimet themelore

Standardet dhe udhëzimet mbështeten mbi një numër parimesh themelore si për Sigurimin e Brendshëm, ashtu dhe atë të jashtëm të cilësisë të AL në HEAL. Këto parime përfshijnë:

- Ofruesit e AL (IAL) kanë përgjegjësinë kryesore për cilësinë e arsimit që ofrojnë dhe sigurimin e saj;
- Interesat e shoqërisë për cilësi dhe standardet e AL duhet të mbrohen e të ruhen;
- Cilësia e programeve akademike nevojitet të zhvillohet dhe të përmirësohet për studentët dhe përfituesit e tjerë të AL në HEAL;
- Nevojitet të ketë struktura organizative të dobishme dhe efikase brenda të cilave programet akademike të mund të sigurohen dhe të mbështeten;
- Transparenca dhe përdorimi i ekspertizës së jashtme në proceset e SC janë të rëndësishme;

- Duhet të inkurajohet krijimi i një kulture cilësie brenda institucioneve të arsimit të lartë;
- Duhet të zhvillohen procese, përmes të cilave IAL-të mund të tregojnë përgjegjshmërinë e tyre, duke përfshirë përgjegjshmërinë për investimin e të ardhurave publike dhe private;
- SC për qëllime përgjegjshmërie është plotësisht i pajtueshëm me SC për qëllime përmirësimi;
- Institucionet duhet të jenë në gjendje të tregojnë cilësinë e tyre brenda vendit dhe ndërkombëtarisht;
- Proceset e përdorura nuk duhet të ndrydhin shumëllojshmërinë apo risinë.

Qëllimet e standardeve dhe udhëzimeve

Qëllimet e standardeve dhe të udhëzimeve janë:

- Të përmirësojnë arsimin në dispozicion të studentëve në IAL-të në HEAL;
- Të asistojnë IAL-të në administrimin dhe përmirësimin e cilësisë së tyre dhe në këtë mënyrë të ndihmojnë e të justifikojnë autonominë e tyre institucionale;
- Të krijojnë një shtrat për agjencitë e SC në punën e tyre;
- Ta bëjnë SJC më transparent dhe më të thjeshtë për t'u kuptuar nga çdokush që është i përfshirë në të.

Objektivat e standardeve dhe udhëzimeve

Objektivat e standardeve dhe udhëzimeve janë:

- Të inkurajojnë zhvillimin e IAL-ve të cilat dëshmojnë arritje arsimore dhe intelektuale ngazëlluese;
- Të sigurojnë një burim asistence dhe drejtimi për IAL-të dhe agjencitë e tjera që lidhen me to për zhvillimin e kulturës së tyre të SC;
- Të informojnë dhe të rritin besimin e IAL-ve, studentëve, punëdhënësve dhe aktorëve të tjerë për proceset dhe rezultatet e AL;
- Të kontribuojnë për një kuadër të përbashkët reference për shërbimin në arsimimin e lartë dhe sigurimin e cilësisë brenda HEAL-s.

Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë

Standardet dhe udhëzimet e propozuara në këtë raport konsiderojnë se Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë luan një rol veçanërisht të rëndësishëm për SC. Forma e tij ndryshon nga sistemi në sistem dhe mund të përfshijë vlerësimet institucionale të llojeve të ndryshme, vlerësimet e lëndëve apo të programeve, akreditimin në nivel lënde, programi dhe institucioni, si dhe kombinimet e këtyre. Vlerësime të tilla të jashtme varen në një masë të qenësishme nga fakti nëse mbështeten në një strategji të qartë të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, me objektiva specifike, dhe gjatë procesit nga fakti nëse nxisin

mekanizma dhe metoda të synuara për arritjen e këtyre objektivave.

Sigurimi i cilësisë mund të ndërmerret nga agjencitë e jashtme për një numër qëllimesh, duke përfshirë:

- Mbrojtjen e standardeve akademike kombëtare për AL;
- Akreditimin e programeve dhe/ose institucioneve;
- Mbrojtjen e konsumatorit;
- Informimin e publikut me të dhëna të verifikuara në mënyrë të pavarur (sasior dhe cilësor) për programet ose institucionet;
- Përmirësimin dhe rritjen e cilësisë.

Aktivitetet e agjencive Europiane të SC do të reflektojnë kërkesat ligjore, sociale dhe kulturore të juridiksionit të vendit dhe mjedisit ku ato veprojnë. Standardet Europiane lidhur me Sigurimin e Cilësisë të vetë Agjencive të SC përmbahen në Pjesën 3 të këtij kapitulli.

Proceset që kryejnë Agjencitë e SC duhet të varen plotësisht nga qëllimet e tyre dhe rezultatet që synojnë të arrijnë. Procedurat që përdorin këto agjenci duhet të synojnë e të theksojnë kryesisht përmirësimin e cilësisë; ato mund të jenë krejt të ndryshme nga ato të agjencive, funksioni kryesor i të cilave është “mbrojtja e fortë e konsumatorit”. Standardet në vijim reflektojnë praktikën më të mirë në SJC në Europë, por nuk përpiqen të drejtojnë në mënyrë të detajuar atë çka duhet të kontrollohet ose si duhet të drejtohen aktivitetet për SC. Këto janë çështje të autonomisë kombëtare, edhe pse, shkëmbimi i informacionit midis agjencive dhe autoriteteve është që t'i udhëheqi ato drejt nevojës për elementë të përbashkët e të ngjashëm.

- Megjithatë, tashmë egzistojnë gjithsesi disa parime të përgjithshme të praktikës së mirë në proceset e SJC:

- Autonomia institucionale duhet të respektohet;
- Interesat e studentëve dhe të interesuarve të tjerë të tillë si përfaqësuesit e tregut të punës duhet të jenë në krye të proceseve të SJC;
- Duhet të përdoren, aty dhe kur është e mundur, edhe rezultatet e aktiviteteve të SBC të vetë institucioneve.

Udhëzimet sigurojnë informacion shtesë rreth praktikave të mira dhe në disa raste shpjegojnë me më shumë detaje kuptimin dhe rëndësinë e standardeve. Megjithëse udhëzimet nuk janë pjesë e vetë standardeve, standardet duhet të konsiderohen të lidhura ngushtë me to.

Pjesa 1: Standardet dhe Udhëzimet Europiane për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në Institucionet e Arsimit të Lartë

I.1 Politikat dhe Procedurat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.

Standard:

Institucionet duhet të kenë politika e procedura shoqëruese për sigurimin e cilësisë dhe standarde për programet dhe diplomat që lëshojnë. Ato duhet gjithashtu të marrin përsipër zhvillimin e një kulture, që njih rëndësinë e cilësisë dhe sigurimit të saj në punën e tyre. Për të arritur këtë, institucionet duhet të zhvillojnë dhe të venë në jetë, një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.

Strategjia, politikat dhe procedurat e ndjekura duhet të jenë të njohura, të kenë një status zyrtar dhe të jenë të kuptueshme nga publiku. Ato duhet të përfshijnë në këtë proces edhe rolin e studentëve dhe të palëve të tjera të interesuara.

Udhëzime:

Politikat formale dhe procedurat sigurojnë një kuadër brenda të cilit IAL-të mund të zhvillojnë dhe të monitorojnë efektivitetin e sistemeve të tyre të sigurimit të cilësisë. Ato gjithashtu ndihmojnë për të fituar besimin e publikut në autonominë e institucionit. Politikat duhet të përmbajnë shprehjen e qëllimeve dhe mjetet kryesore për arritjen e tyre. Udhëzimet procedurale mund të japin më shumë informacion të detajuar rreth mënyrave se si politikat vihen në jetë dhe sigurojnë një pikë reference të dobishme për ata që duan të njihen me aspektet praktike të zbatimit të procedurave.

Procedurat duhet të përfshijnë:

- Marrëdhënien midis mësimdhënies dhe kërkimit në institucion;
- Strategjinë e institucionit për cilësinë dhe standardet;
- Organizimin e sistemit të sigurimit të cilësisë;
- Përgjegjësitë e departamenteve, shkollave, fakulteteve dhe njërive/individëve të tjerë organizativë për sigurimin e cilësisë;
- Përfshirjen e studentëve në sigurimin e cilësisë;
- Mënyrat e zbatimit, monitorimit dhe rishikimit të politikës së IAL.

Realizimi i Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë (HEAL) varet kryesisht nga angazhimi i institucionit në të gjitha nivelet, për të siguruar programe me pikësnyime të qarta dhe të menduara saktë; një staf të aftë dhe të përkushtuar, të sigurojë mësimdhënie cilësore dhe mbështetjen e plotë të studentëve, e cila do t'i ndihmojë ata në arritjen e këtyre rezultateve dhe të njihet e të vlerësohet kontributi i asaj pjese të stafit që shquhet për

ekselencë, ekspertizë dhe përkushtim. Të gjitha IAL duhet të synojnë përmirësimin, nxitjen dhe rritjen cilësore të formimit që i ofrojnë studentëve të tyre.

1.2. Miratimi, monitorimi dhe rivlerësimi periodik i programeve dhe diplomave

Standard:

Institucionet duhet të kenë mekanizma zyrtarë për miratimin, monitorimin dhe rishikimin periodik të programeve dhe diplomave.

Udhëzime:

Besimi i studentëve dhe aktorëve të tjerë në Arsimin e Lartë duhet të vendoset dhe të mbahet përmes aktiviteteve të sigurimit të cilësisë, të cilat sigurojnë që programet të jenë të projektuara mirë, të monitoruara periodikisht, që ato të jenë në vazhdimësi të përshtatshme dhe bashkëkohore.

Sigurimi i cilësisë së programeve/diplomave duhet të përfshijë:

- Zhvillimin dhe publikimin e rezultateve të pritshme e të qarta të të mësuarit;
- Vëmendje të kujdesshme në hartimin dhe përmbajtjen e kurrikulës dhe programeve;
- Nevojat specifike për sistemet e ndryshme të shkollimit (psh me kohë të plotë, kohë të pjesëshme, mësimi në distancë, e-learning) dhe llojet e Arsimit të Lartë (psh akademik, teknik , profesional);
- Vlefshmërinë dhe disponibilitetin e burimeve të të mësuarit;
- Miratimin zyrtar të programeve, nga grupe të posaçme, të ndryshme nga ata që i japin këto programe;
- Monitorimin e progresit dhe arritjeve të studentëve;
- Rishikime periodike, të rregullta të programeve (duke përfshirë antarë të jashtëm);
- Feedback të rregullt nga punëdhënësit, përfaqësuesit e tregut të punës dhe organizma të tjerë të rëndësishëm;
- Pjesëmarrjen e studentëve në aktivitetet e sigurimit të cilësisë.

1.3 Vlerësimi i studentëve

Standard:

Studentët duhet të vlerësohen duke përdorur kritere të publikuara, rregulla, dhe procedura të cilat zbatohen rregullisht dhe me rigorozitet.

Udhëzime:

Vlerësimi i studentëve është një nga elementet më të rëndësishëm të Arsimit të Lartë. Rezultatet e vlerësimit kanë një ndikim të rëndësishëm në karrierën e ardhshme të

studentëve. Pra është e rëndësishme që vlerësimi i tyre të bëhet gjithmonë në mënyrë profesionale dhe duke patur njohuri të gjera mbi proceset e testimit dhe provimeve.

Procedurat për vlerësimin e studentëve duhet të jenë:

- Të hartuara në mënyrë të tillë që matin arritjet në rezultatet e pritshme të të mësuarit dhe në qëllimet e tjera të programeve;
- T'i përshtaten qëllimeve, të çfarëdo forme qofshin, diagnostikuese, edukuese e përmbledhëse;
- Të ketë kritere të qarta dhe të publikuara për vendosjen e notave;
- Të ndërmerren nga persona që e kuptojnë rolin e vlerësimit në përparimin e studentëve drejt marrjes së njohurive dhe aftësive, që lidhen me kualifikimet që synohen prej tyre;
- Ku është e mundur, të mos mbështeten në gjykimin e një personi të vetëm;
- Të merren parasysh të gjitha pasojat e mundshme të rregullave të provimeve;
- Të kenë rregulla të qarta që mbulojnë mungesat e studentëve, sëmundjet dhe rrethana të tjera lehtësuese;
- Të sigurojnë se vlerësimet janë bërë në përputhje me procedurat e vendosura nga institucionet;
- Të jenë subjekt i kontrolleve verifikuese administrative për të siguruar zbatimin me përpikmëri të procedurave.

Përveç kësaj, studentët duhet të jenë të informuar për strategjinë e vlerësimit që përdoret për programet e tyre, natyrën e provimeve apo metodave të tjera të vlerësimit të cilave do ju nënshtrohen, çfarë pritet prej tyre dhe kriteret që aplikohen për vlerësimin e formimit të tyre.

I.4 Sigurimi i Cilësisë së stafit akademik

Standard:

Institucionet duhet të kenë mënyra për të siguruar që stafi i përfshirë në mësimdhënien e studentëve të jetë i kualifikuar dhe i aftë. Ata duhet të jenë në dispozicion të atyre që ndërmarrin vlerësimin e jashtëm dhe të japin komente mbi raportet e tyre.

Udhëzime:

Mësimdhënësi është burimi i vetëm, më i rëndësishëm i të mësuarit, i disponueshëm për shumicën e studentëve. Është e rëndësishme që ata që japin mësim të kenë njohuri dhe kuptim të plotë të lëndës që japin, të kenë aftësitë dhe përvojën e nevojshme për të transmetuar në mënyrë efektive njohuritë dhe kuptueshmërinë te studentët në kontekstin e mësimdhënies, si dhe të pranojnë feedback-un nga ata për punën e tyre. Institucionet duhet të sigurohen që rekrutimi i stafit të tyre dhe procedurat e caktuara për këtë qëllim të bëjnë të mundur dhe të sigurojnë që i gjithë stafi i ri të

ketë të paktën nivelin minimum të nevojshëm të aftësisë. Stafit mësimor duhet t'i jepet mundësia për të zhvilluar dhe për të zgjeruar kapacitetin e tij mësimdhënës dhe duhet të inkurajohet për të vlerësuar aftësitë e tij. Institucionet duhet t'i japin stafit me nivel më të ulët, mundësi për të përmirësuar aftësitë e tij në një nivel të pranueshëm dhe duhet të kenë mjetet për t'i larguar ata nga detyra e mësimdhënies nëse vazhdojnë të jenë joefektivë.

I.5 Fasilitetet dhe shërbimet për studentët

Standard:

Institucionet duhet të sigurojnë burime të disponueshme për mbështetjen e të mësuarit të studentëve; ato duhet të jenë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për çdo program të ofruar.

Udhëzime:

Përveç mësimdhënësve të tyre, studentët duhet të mbështeten nga një gamë burimesh që ndihmon të mësuarit të tyre. Kjo ka të bëjë si me burimet fizike si bibliotekat, mjetet kompjuterike, e deri tek mbështetja njerëzore në formë tutorësh, këshilltarësh e konsulentësh të tjerë. Burimet e të mësuarit dhe mekanizmat e tjerë mbështetës, duhet të jenë lehtësisht të arritshëm nga studentët, të projektuara duke patur parasysh nevojat e tyre dhe të reagojë lehtësisht ndaj feedback-ut të atyre që i përdorin këto shërbime.

Fasilitetet e mësimdhënies dhe mbështetja e studentëve duhet të jenë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për çdo program të ofruar.

Institucionet duhet të monitorojnë, të rishikojnë dhe të përmirësojnë rregullisht efektivitetin e shërbimeve në dispozicion të studentëve.

I.6 Sistemet e informacionit

Standard:

Institucionet duhet të sigurojnë mbledhjen, analizimin dhe përdorimin e një informacioni të përshtatshëm për sigurimin efektiv të cilësisë së programeve të tyre të studimit dhe aktiviteteve të tjera.

Udhëzime:

Njohja e vetvetes nga ana e institucionit është pika fillestare për sigurimin efektiv të cilësisë. Është e rëndësishme që institucionet të kenë mjetet për mbledhjen dhe analizimin e informacionit për aktivitetet e tyre. Pa këtë, ata nuk mund të mësojnë se çfarë ecën mirë dhe çfarë kërkon vëmendje, si dhe nuk mund të vlerësojnë rezultatin

e praktikave të reja.

Sistemet e informacionit lidhur me cilësinë, të kërkuara nga çdo institucion, varen nga rrethanat lokale, por duhet që të mbulojnë të paktën:

- Progresin e studentëve dhe shkallën e suksesit;
- Punësimin e të diplomuarve;
- Sa të kënaqur janë studentët nga programet e tyre;
- Efektivitetin e stafit akademik;
- Profilin e komunitetit të studentëve;
- Burimet e disponueshme të mësimdhënies dhe kostot e tyre;
- Indikatorët kyç të performancës së vetë institucionit.

Për këtë qëllim, ka gjithashtu vlerë edhe krahasimi i vetë institucioneve me organizime të tjera të ngjashme brenda HEAL dhe jashtë saj. Kjo i lejon ata të zgjerojnë gamën e njohjes së vetvetes dhe të përcaktojnë rrugët për përmirësimin e performancës së tyre.

1.7 Informimi i publikut

Standard:

Institucionet duhet të publikojnë rregullisht informacion të freskët, të paanshëm e objektiv, si sasior ashtu edhe cilësor, për programet dhe diplomat që ato ofrojnë.

Udhëzime:

Në përmbushjen e rolit kundrejt publikut, IAL-të kanë përgjegjësi për të siguruar informacion rreth programeve që ofrojnë, rezultatet e tyre të pritshme të të mësuarit (learning outcomes), kualifikimet që ata japin, mësimdhënien, procedurat e përdorura për të mësuarit dhe vlerësimet, si dhe mundësitë e të mësuarit në dispozicion të studentëve. Informacioni i publikuar duhet të përfshijë pikëpamjet dhe destinacionet e punësimit të studentëve të kaluar dhe profilin e popullatës studentore të momentit. Ky informacion duhet të jetë i saktë, i paanshëm, objektiv dhe lehtësisht i arritshëm, dhe nuk duhet të përdoret thjesht për qëllime marketingu. Institucioni duhet të ketë mjete për të verifikuar në se i plotëson kriteret e paanshmërisë dhe objektivitetit.

Pjesa 2: Standardet dhe Udhëzimet Evropiane për Sigurimin e Jashtëm të Cilësisë në Arsimin e Lartë

2.1 Përdorimi i Procedurave për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë

Standard:

Procedurat për Sigurimin e Jashtëm të Cilësisë duhet të marrin në konsideratë efektivitetin e proceseve për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë të përshkruara në pjesën e parë të “Udhëzime dhe Standarde Evropiane”

Udhëzime:

Standardet për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë të përmendura në Pjesën I, sigurojnë një bazë të vlefshme për procesin e SJC. Është e rëndësishme që politikat dhe procedurat e brendshme të vlerësohen me kujdes gjatë procedurave të vlerësimit të jashtëm, për të përcaktuar se si dhe në ç’shikime janë plotësuar standardet.

Nëse IAL-të arrijnë të tregojnë efektivitetin e proceseve të tyre të brendshme për Sigurimin e Cilësisë, dhe në qoftë se këto procese sigurojnë cilësinë dhe plotësojnë standardet plotësisht, atëherë procesi i vlerësimit të Jashtëm mund të jetë më pak intensiv nga sa parashikohet normalisht.

2.2 Zhvillimi i proceseve për SJC (Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë)

Standard:

Qëllimet dhe objektivat e proceseve të Sigurimit të Cilësisë duhet të përcaktohen përpara se proceset të zhvillohen, nga palët përgjegjëse në to (duke përfshirë dhe IAL-të) dhe duhet të publikohen, të shoqëruara me një përshkrim të procedurave që do të përdoren.

Udhëzime:

Në mënyrë që të sigurohet qartësia e qëllimit dhe transparenca e procedurës, metodat e SJC, duhet të planifikohen dhe të zhvillohen përmes një procesi që përfshin aktorët kyç, pra IAL-të. Pasi miratohen, procedurat duhet të publikohen dhe duhet të përmbajnë të shprehura qartë, qëllimet dhe objektivat e proceseve të përshkruara që do të përdoren.

Ndërkohë që SJC vendos kërkesa ndaj IAL-ve të përfshira, duhet të parashikohet ndikimi paraprak i vlerësimit, për t’u siguruar që, procedurat që do adaptohen, të jenë të përshtatshme dhe nuk ndërhyjnë më tepër sesa është e nevojshme në punën normale të IAL.

2.3 Kriteret për vendimmarrjen.

Standard:

Çdo vendim zyrtar i marrë si rezultat i një aktiviteti për SJC duhet të bazohet mbi kritere të qarta të publikuara që aplikohen në mënyrë të vazhdueshme.

Udhëzime:

Vendimet zyrtare të marra nga Agjencitë për Sigurimin e Cilësisë kanë një ndikim të madh mbi institucionet dhe programet që vlerësohen. Në favor të paanësisë dhe seriozitetit, vendimet duhet të bazohen në kritere të publikuara dhe të interpretuara në një mënyrë konsekuente. Përfundimet duhet të bazohen në fakte të shkruara dhe agjencitë duhet të vendosin edhe mënyra për të rishikuar e ndryshuar përfundimet, nëse është e nevojshme.

2.4 Proceset - të përshtatura për qëllimin (fit for purpose)

Standard:

Të gjitha proceset për SJC duhet të hartohen në mënyrë specifike për të siguruar përshtatjen e tyre për arritjen e qëllimeve dhe objektivave të vendosura për to.

Udhëzime:

Agjencitë e Sigurimit të Cilësisë që operojnë në Hapësinë Europiane për Arsimin e Lartë (HEAL) ndërmarrin procese të jashtme të ndryshme, për qëllime të ndryshme dhe në mënyra të ndryshme. Është e një rëndësie parësore që agjencitë të veprojnë me procedura të cilat janë të përshtatura për qëllimet e tyre, të përcaktuara dhe të bëra publike. Eksperienca ka treguar, sidoqoftë, që ka disa elemente të proceseve të vlerësimit të jashtëm që përdoren gjerësisht, të cilat jo vetëm ndihmojnë për të siguruar vlefshmërinë, përgjegjshmërinë dhe dobishmërinë, por gjithashtu sigurojnë një bazë për krijimit e Dimensionit European në Sigurimin e Cilësisë.

Midis këtyre elementeve, me rëndësi të veçantë për t'u përmendur, janë si më poshtë:

- Këmbëngulja që ekspertët që ndërmarrin aktivitetin për SJC, të kenë aftësitë e përshtatshme dhe të jenë kompetentë në kryerjen e detyrës së tyre;
- Kujdesi në përzgjedhjen e ekspertëve;
- Masat për udhëzime apo trainime të nevojshme të ekspertëve;
- Angazhimi i ekspertëve të huaj;
- Pjesëmarrja e studentëve;
- Sigurimi që procedurat e vlerësimit të ndjekura, të jenë të mjaftueshme për të siguruar tregues të përshtatshëm që mbështetin gjetjet dhe përfundimet e arritura;

- Përdorimi i modelit: vetëvlerësim/vizita e jashtme (site-visit)/draft raporti/raporti i publikuar/plani i vazhdimësisë;
- Të njihet rëndësia e përmirësimit institucional dhe përmirësimit të politikave si një element thelbësor në Sigurimin e Cilësisë.

2.5 Raportimi

Standard:

Raportet duhet të publikohen dhe duhet të shkruhen me një stil të qartë dhe të kuptueshëm për grupin e lexuesve të cilit i drejtohet. Çdo vendim, koment apo rekomandim që përmban raporti duhet të jetë i lehtë për t'u kuptuar për çdo lexues.

Udhëzime:

Me qëllim që të sigurohet përfitimi maksimal nga proceset e SJC, është e rëndësishme që raportet të plotësojnë nevojat e identifikuar të lexuesit. Ndonjëherë raportet i drejtohen grupeve të ndryshme lexuesish dhe kjo kërkon t'i kushtohet kujdes i veçantë strukturës, përmbajtjes, stilit dhe tonit të të shkruarit.

Në përgjithësi raportet duhet të strukturohen në mënyrë të tillë që të përfshijnë: përshkrime, analiza (që përfshijnë të dhëna të fushës përkatëse), përfundime, urdhëra dhe rekomandime. Ai duhet të përmbajë shpjegime paraprake të mjaftueshme për të bërë të mundur që, edhe një lexues jo i fushës, të kuptojë qëllimet e rivlerësimit, formën e tij dhe kriteret e përdorura në marrjen e vendimeve. Pikat kyçe, përfundimet dhe rekomandimet duhet të jenë lehtësisht të dallueshme për lexuesit.

Raportet duhet të publikohen në një formë lehtësisht të gjatshme dhe duhet të krijohet mundësia për lexuesit dhe përdoruesit e raportit (të dy si brenda dhe jashtë institucionit në fjalë) për të komentuar mbi dobishmërinë e tij.

2.6 Procedurat vazhduese

Standard:

Proceset e Sigurimit të Cilësisë të cilat përmbajnë rekomandime për veprime ose të cilat kërkojnë një plan pasues veprimi, duhet të kenë një procedurë vazhduese të paracaktuar, e cila zbatohet në mënyrë të vijueshme.

Udhëzime:

Sigurimi i Cilësisë ka si qëllim parësor kërkimin dhe investigimin thjesht për raste individuale; ajo kërkon të sigurojë vazhdimësinë dhe të nxisë përpjekje të vazhdueshme për të bërë një punë më të mirë. SJC nuk përfundon me publikimin e raportit dhe duhet të përfshijë një procedurë të strukturuar vazhduese për të bërë të mundur që

rekomandimet, të shoqërohen me planet e duhura të veprimit dhe të përshtatshme, që hartohen dhe zbatohen. Kjo mund të përfshijë takime të mëtejshme me përfaqësuesit e institucionit apo të programeve. Objektivi është që të sigurohet që në sferat e identifikuar për përmirësim, të vepohet me shpejtësi dhe të nxitet përmirësimi i mëtejshëm.

2.7 Rivlerësime periodike

Standard:

SJC i institucioneve dhe/ose programeve, duhet të ndërmerret mbi baza ciklike. Kohëzgjatja e një cikli dhe procedurat e rivlerësimit që do të përdoren, duhet të jenë të përcaktuara qartë dhe të publikuara paraprakisht.

Udhëzime:

Sigurimi i cilësisë nuk është një proces statik, por dinamik. Ai duhet të jetë i vazhdueshëm dhe jo “një herë në jetë”. Ai nuk mbaron me vlerësimin e parë ose me përfundimin e procedurës zyrtare të planit të vazhdimësisë. SC duhet të përditësohet periodikisht. Rivlerësimet e jashtme pasuese duhet të marrin në konsideratë progresin që është bërë nga hera e fundit. Procesi që do të ndiqet në të gjitha rivlerësimet e jashtme duhet të jetë i përcaktuar qartë nga Agjencia për SJC dhe kërkesat ndaj institucionit (njësisë) nuk duhet të jenë më të larta se sa është e nevojshme për arritjen e objektivave të këtij procesi.

2.8 Analiza e të gjithë sistemit

Standard:

Agjencitë për Sigurimin e Cilësisë duhet të nxjerrin herë pas here raporte përmbledhëse që përshkruajnë dhe analizojnë gjetjet e përgjithshme të rivlerësimeve, vlerësimeve etj.

Udhëzime:

Të gjitha Agjencitë për Sigurimin e Jashtëm të Cilësisë mbledhin një informacion të pasur për programet individuale dhe/ose institucionet, i cili siguron material për analiza të strukturuar për të gjithë sistemin e Arsimit të Lartë. Analiza të tilla sjellin informacion shumë të dobishëm për zhvillimet, prirjet, evidentimin e praktikës së mirë, fushat e vështirësive ose dobësive, që të mund të bëhen instrumenta të dobishëm për politikat e zhvillimit dhe për përmirësimin e cilësisë. Agjencitë duhet të përfshijnë aktivitete kërkimi dhe zhvillimi në veprimtarinë e tyre për të nxjerrë përfitimin maksimal nga kjo punë.

Hyrje për Pjesën e 3-të: Standardet Europiane dhe Udhëzimet për Agjencitë e Jashtme të Sigurimit të Cilësisë.

Rritja e Agjencive Europiane të Sigurimit të Jashtëm të Cilësisë është zgjeruar duke nisur që nga fillimi i viteve '90. Në të njëjtën kohë, kooperimi dhe ndarja e praktikës së mirë ndërmjet agjencive, ka qenë një element integruar në këtë zhvillim. Që në 1994/95, i ashtuquajturit Projekti Pilot Europian, i inicuar nga Komisioni Europian, pati si rezultat njohjen e ndërsjellë nga agjencitë, të një metodologjie bazë për sigurimin e cilësisë: në Rekomandimet e Këshillit të BE në 1998, u formuluan agjencitë e pavarura, vetë-vlerësimi, rrjeti i vizitave të jashtme dhe raportimi publik për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. Krijimi i ENQA (European Network for Quality Assurance) në vitin 2000, ishte pasojë e një formalizimi të natyrshëm të këtij zhvillimi në bashkëveprim, dhe ENQA ka qenë e aftë të ndërtojë konsensusin më të mirë, të arritur gjatë viteve 1990.

Standardet Europiane për agjencitë e sigurimit të jashtëm të cilësisë që vijojnë, janë zhvilluar mbi premisat e këtij zhvillimi në historinë e re Europiane të sigurimit të jashtëm të cilësisë. Për më tepër është një ambicje e vetëdijshme që standardet nuk duhet që të jenë as shumë të detajuara dhe as shumë urdhëruese. Ato nuk duhet të kufizojnë lirinë e agjencive Europiane të sigurimit të cilësisë për të reflektuar në organizimet dhe proceset e tyre pritshmërinë e kombit apo rajonit të tyre. Megjithatë standardet, duhet të garantojnë që të dalë në mënyrë të qartë dhe transparente profesionalizmi, kredibiliteti dhe integriteti i agjencive tek aktorët e tyre kryesorë dhe agjencitë duhet të lejojnë krahasueshmërinë për të qenë të dallueshëm midis tyre dhe të lejojnë dimensionet e nevojshme Europiane.

Duhet të shtojmë që në këtë mënyrë standardet kontribuojnë natyrshëm në punën e bërë në drejtim të njohjes së ndërsjellë të agjencive dhe rezultateve të vlerësimeve ose akreditimeve të tyre. Kjo punë u zhvillua nga Nordic Quality Assurance Network in Higher Education (NOQA) dhe është bërë pjesë e “Kodit të Praktikës së Mirë” (“Code of Good Practise”) nga Konsorciumi Europian për Akreditimin (European Consortium for Accreditation - ECA).

Për të dhënë më shumë informacion rreth praktikave pozitive dhe për të shpjeguar në disa raste në më shumë detaje kuptimin dhe rëndësinë e standardeve, janë shkruar disa “udhëzime” të tjera. Ndonëse udhëzuesit nuk janë pjesë e vetë standardeve, standardet duhet të konsiderohen e kuptohen të lidhura ngushtë me to.

Pjesa 3: Standardet Europiane për Agjencitë e Jashtme të Sigurimit të Cilësisë.

3.1 Përdorimi i Procedurave të Sigurimit të Jashtëm të Cilësisë për Arsimin e Lartë.

Standard:

Sigurimi i jashtëm i cilësisë i agjencive duhet të marrë në konsideratë praninë dhe efektivitetin e proceseve të jashtme të sigurimit të cilësisë, të përshkruara në Pjesa 2 të “Standarde dhe Udhëzime Europiane”.

Udhëzime:

Standardet për sigurimin e jashtëm të cilësisë që përmban Pjesa 2, sigurojnë një bazë të vlefshme për procesin e jashtëm të sigurimit të cilësisë. Standardet reflektojnë praktikën më të mira dhe përvojat e fituara gjatë zhvillimit të sigurimit të jashtëm të cilësisë në Europë që prej viteve 1990. Prandaj është e rëndësishme që këto standarde të integrohen brenda proceseve që zbatojnë agjencitë e jashtme të sigurimit të cilësisë për Institucionet e Arsimit të Lartë.

Standardet për sigurimin e jashtëm të cilësisë duhet që, së bashku me standardet për agjencitë e jashtme të sigurimit të cilësisë, të përbëjnë bazat për një sigurim të jashtëm të cilësisë profesional dhe të besueshëm të Institucioneve të Arsimit të Lartë.

3.2 Statusi zyrtar

Standard:

Agjencitë duhet të jenë zyrtarisht të njohura nga autoritetet kompetente publike në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë, si agjenci me përgjegjësinë për SJC dhe duhet të jenë të ngritura mbi baza ligjore. Ato duhet të pajtohen me çdo kërkesë të juridiksionit legjislativ brenda të cilit ato veprojnë.

3.3 Aktivitetet.

Standard:

Agjencitë duhet të marrin përsipër aktivitetet e jashtme të sigurimit të cilësisë (në nivel institucional/programesh) mbi baza të rregullta.

Udhëzime:

Këto mund të përfshijnë vlerësimin, rivlerësim, vlerësim (assessment), auditimin,

akreditimin ose veprimtari të tjera të ngjashme, dhe duhet të përbëjnë thelbin funksional të agjencisë.

3.4 Burimet

Standard:

Agjencitë duhet të kenë burime të përshtatshme dhe proporcionale, si njerëzore ashtu edhe financiare, për t'u mundësuar atyre organizimin dhe ndjekjen e proceseve të sigurimit të jashtëm të cilësisë në mënyrë sa më efektive dhe efçente, në masën e duhur për zhvillimin e proceseve dhe procedurave të tyre.

3.5 Formulimi i misionit

Standard:

Agjencitë duhet të kenë synime dhe objektiva të qarta dhe të përcaktuara për punën e tyre, e cila duhet të përfshihet në një formulim të disponueshëm publikisht.

Udhëzime:

Këto formulime duhet të përshkruajnë synimet dhe objektivat e proceseve për sigurimin e cilësisë të agjencisë, ndarjen e punës me palët e tjera të interesuara për AL e në veçanti me institucionet e arsimit të lartë, dhe kontekstin historik dhe kulturor të punës së tyre. Formulimi duhet të bëjë të qartë se procesi i jashtëm i sigurimit të cilësisë përbën veprimtarinë kryesore të agjencisë dhe se ajo punon në mënyrë sistematike për të realizuar synimet dhe objektivat e saj. Gjithashtu agjencia duhet të zotërojë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që dëshmon se ajo çka formulohet në misionin e saj, është përkthyer në politika dhe plane të qarta administrimi.

3.6 Pavarësia

Standard:

Agjencitë duhet të jenë të pavarura deri në masën që ato të kenë përgjegjësi autonome për veprimtaritë e tyre ashtu edhe që përfundimet dhe rekomandimet që sjellin në raportet e tyre të mos ndikohen nga palë të treta siç janë IAL-të, ministritë ose palë të tjera të interesuara.

Udhëzime:

Një agjenci nevojitet të tregojë pavarësinë e saj nëpërmjet masave të tilla si:

- Pavarësia e saj vepruese nga institucionet e arsimit të lartë dhe qeveria të garantohet në dokumenta zyrtare (psh: aktet ligjore dhe nënligjore).

- Përcaktimi dhe veprimtaria e procedurave dhe metodave të saj, emërimi dhe përzgjedhja e ekspertëve të jashtëm dhe përcaktimi i përfundimeve të proceseve të tyre të sigurimit të cilësisë, të ndërmerren në mënyrë autonome dhe të pavarura nga qeveria, IAL-të dhe organet me ndikim politike.
- Megjithëse në rrjedhën e proceseve të sigurimit të cilësisë, konsultohen faktorët kryesorë të lidhur me AL, veçanërisht studentët/mësimxënësit, përfundimet kryesore të proceseve të sigurimit të cilësisë mbeten në përgjegjësinë e agjencisë.

3.7 Kriteret e Sigurimit të Jashtëm të Cilësisë dhe proceset e përdorura nga agjencitë

Standard:

Proceset, kriteret dhe procedurat e përdorura nga agjencitë duhet të jenë të paracaktuara dhe të disponueshme publikisht. Këto procese normalisht pritet që të përfshijnë:

- Një vetëvlerësim ose procedurë ekuivalente nga subjekti në proces të SC
- Një vlerësim të jashtëm nga një grup ekspertësh që përfshin si të përshtatshëm një (disa) anëtar(ë) student(ë) dhe një (disa) vizitë(a) në vend (site-visits) të vendosura nga agjencia;
- Publikimin e një raporti, që përfshin vendime, rekomandime apo rezultate të tjera zyrtare;
- Një Plan Vazhdimësie për të rivlerësuar veprimet e ndërmarra nga subjekti në procesin e SC, nën dritën e rekomandimeve që përmbahen në raport.

Udhëzime:

Agjencitë mund të zhvillojnë dhe përdorin procese dhe procedura të tjera për qëllime të veçanta.

Agjencitë duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë parimeve të tyre të deklaruara gjatë gjithë kohës, dhe të sigurojnë që si kërkesat dhe proceset e tyre të menaxhohen profesionalisht, dhe që përfundimet e vendimet, megjithëse merren nga grupe të ndryshme personash, të merren në mënyrë të përshtatshme e të qëndrueshme.

Agjencitë që nxjerrin përfundime ose marrin vendime formale të sigurimit të cilësisë, dhe që kanë pasoja formale duhet të kenë një procedurë apelimi. Natyra dhe forma e procedurës së apelitit duhet të jetë e përcaktuar në bazën ligjore të çdo agjencie.

3.8 Procedurat për përgjegjshmërinë.

Standard:

Agjencitë duhet të kenë vendosur procedurat për vetëpërgjegjshmërinë e tyre.

Udhëzime:

Këto procedura pritet të përfshijnë si më poshtë:

1. Një politikë të publikuar për sigurimin e cilësisë të vetë agjencisë, që të jetë e disponueshme në website-n e saj;
2. Dokumentacion që dëshmon se:
 - proceset dhe rezultatet e agjencisë pasqyrojnë misionin dhe synimet e saj për SC;
 - agjencia ka dhe zbaton mekanizma që sigurojnë mënjanimin e konfliktit të interesave në punën e ekspertëve të saj të jashtëm;
 - agjencia ka mekanizmat e duhur që sigurojnë cilësinë në çdo aktivitet dhe material të prodhuar nga nënkontraktuesit, nqs disa ose të gjithë elementët në procedurat e saj të sigurimit të cilësisë janë nënkontraktuar nga palë të tjera;
 - agjencia ka vendosur procedurat e brendshme të sigurimit të cilësisë të cilat përfshijnë një mekanizëm të brendshëm feedback-u (kjo nënkupton mbledhjen e feedback-ut nga vetë stafi dhe këshilli/bordi); një mekanizëm të brendshëm reflektimi (kjo nënkupton reagim ndaj rekomandimeve të brendshme dhe të jashtme për përmirësim); një mekanizëm të jashtëm feedback-u (kjo nënkupton mbledhjen e një feedback-u nga ekspertët dhe institucionet e rivlerësuara për një zhvillim në të ardhmen) për të informuar dhe përforcuar vetë zhvillimin dhe përmirësimin e saj.
3. Një rivlerësim ciklik të jashtëm të detyrueshëm për veprimtarinë e agjencisë të paktën çdo pesë vjet.

3. Sistemi i Vlerësimit të Jashtëm për Agjencitë e Sigurimit të Cilësisë (ASC).

Në Berlin, Ministrat i kërkuan “ENQA-s, që, nëpërmjet anëtarëve të saj, në bashkëpunim me EUA, EURASHE, dhe ESIB, të gjente mënyrat për sigurimin dhe përshtatjen e një sistemi vlerësimi të jashtëm të përshtatshëm për Agjencitë ose Organizmat e Akreditimit dhe të Sigurimit të Cilësisë”.

ENQA dhe partnerët e saj, e kanë bërë këtë deklaram duke u bazuar në interpretimin e mandatit që një sistem i vlerësimit të jashtëm i agjencive duhet të përfshijë jo vetëm vetë procesin e vlerësimit të jashtëm në vetvete, por gjithashtu një vëmendje të kujdesshme ndaj standardeve të cilësisë mbi të cilat do të mbështetet ky vlerësim. Përveç kësaj, gjatë procesit u ra dakord që vlerësimi i jashtëm i agjencive duhet të interpretohet si themelore për të arritur synimet e transparencës, largpamësisë, dhe krahasueshmërisë së Agjencive të Akreditimit.

Prandaj, ky raport propozon si kryesore, krijimin e një regjistri të agjencive të Sigurimit të Jashtëm të Cilësisë të njohura që veprojnë në AL në të gjithë Europën. Ky propozim është në thelb një përgjigje ndaj besimit që së shpejti do të ketë një rritje të trupave (organizmave) të sigurimit të cilësisë që do dëshirojnë të nxjerrin përfitime nga vlera që ka etiketa e njohjes ose akreditimit. Përvoja gjetkë ka treguar se është e vështirë të kontrollohen këto iniciativa, por Europa, ka ndoshta një mundësi të vetme të ushtrisë administrimit praktik, në këtë treg të ri, jo me kuptimin për të ruajtur interesat e agjencive tashmë të krijuara, por për të siguruar atë që përfitimet e sigurimit të cilësisë, të mos zvogëlohen nga veprimtaria e praktikuesve pa reputacion në këtë fushë.

Puna për këto propozime ka marrë në radhë të parë në konsideratë kontekstin dhe kërkesat Europiane. Në të njëjtën kohë ka një vetëdije në proces nga përvoja dhe procese të ngjashme që janë zhvilluar në rang ndërkombëtar. Ky kapitull hapet me një analizë të shkurtër të përvojave ndërkombëtare dhe iniciativave të ngjashme për hartimin e kësaj pjese të raportit. Ai pastaj nënvizon se sistemi i vlerësimit të jashtëm i propozuar, bazohet në parimin e shprehjes së vullnetit (subsidiarity) dhe në Standardet Europiane për Agjencitë e SJC. Ky nënvizim na drejton në prezantimin e regjistrit të rekomanduar të agjencive për SJC të cilat veprojnë në Europë. Vlerësimi i jashtëm dhe agjencitë në pajtim me Standardet Europiane luajnë një rol kryesor në hartimin e

regjistrin. Së fundi, propozohet një Forum Konsultativ Europian (European Consultative Forum) për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Konteksti ndërkombëtar

Europa nuk është zona e vetme ku aktualisht po ndodh një zhvillim dinamik në fushën e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Kjo pjesë përshkruan disa nga përvojat dhe iniciativat e organizatave të tilla si International Network for Quality Assurance Agencies in Higher Education (INQAAHE), International Association of University Presidents (IAUP), Council for Higher Education Accreditation in the United States (CHEA), OECD, UNESCO. Puna e këtyre organizmave në lidhje me sigurimin e cilësisë është parë si e dobishme gjatë hartimit të këtij raporti. Edhe pse këto përvoja ndërkombëtare nuk janë përfshirë në mënyrë direkte në rekomandimet specifike, disa elementë kyç ndërkombëtarë janë paraqitur më poshtë për të krijuar lidhjen me rekomandimet e këtij kapitulli.

Identifikimi i cilësisë dhe praktikës së mirë të agjencive të SJC gjithashtu ka qenë në axhendën ndërkombëtare për disa vjet. INQAAHE diskutoi në 1999 dhe më pas për një etiketë cilësie për agjencitë e SJC, një ide origjinale e inicuar nga IAUP, me synimin për të plotësuar nevojën e IAL-ve për të identifikuar se cilat agjenci janë të kualifikuara për të përmbushur rolin e SJC. Etiketimi i cilësisë ndeshi një kundërshtim të gjerë dhe në vend të kësaj, INQAAHE u përqendrua në formulimin e kriterëve të praktikës së mirë për agjencitë. Rezultati ishte hartimi i një tërësie parimesh që paraqesin emëruesit e përbashkët të praktikës së mirë dhe në të njëjtën kohë njohin diversitetin ndërkombëtar të agjencive përsa i përket synimeve dhe kontekstit historik-kulturor.

Përsa i përket rekomandimeve mbi agjencitë e vlerësimit të jashtëm, puna e bërë nga CHEA është e dukshme. CHEA është organizatë jo qeveritare që funksionon si një organizëm ombrellë për Agjencitë rajonale të akreditimit, të specializuara, kombëtare dhe profesionale në SHBA. Organizatat akredituese që kërkojnë të njihen nga CHEA duhet të dëshmojnë se ato njohin dhe plotësojnë standardet e pranimit në CHEA. Organizatat akredituese pritet të zhvillojnë cilësinë akademike, të tregojnë përgjegjshmëri, të inkurajojnë përmirësimin, të përdorin procedurat e duhura, të rishohin në mënyrë të vijueshme praktikat e akreditimit dhe të zotërojnë burime të mjaftueshme. CHEA do të kërkojë që këto anëtarë t'i nënshtrohen të ashtuquajturave rivlerësime për njohjen e tyre çdo 6 vjet. Ka ngjashmëri dhe përshtatshmëri themelore midis modelit të CHEA dhe propozimeve në këtë raport, për shembull përsa i përket rivlerësimeve ciklike. Megjithatë ky raport i ka dhënë prioritet një fokusi të veçantë, sigurimit të cilësisë të agjencive.

Një iniciativë e veçantë është ndërmarrë në bashkëpunim me OECD dhe

UNESCO-n për të shtjelluar udhëzimet për dispozitat e cilësisë në të gjithë Arsimin e Lartë. Udhëzimet e OECD-UNESCO do të finalizohen në 2005, por procesi i hartimit identifikoi kontrastin midis nevojave për të rregulluar internacionalizimin e arsimit të lartë dhe faktit se kapacitetet ekzistuese kombëtare të sigurimit të cilësisë shpesh përqendrohen ekskluzivisht në të dhënat e brendshme nga institucionet e çdo vendi. Kështu që, sistemet e tanishme të sigurimit të cilësisë ndodhen përpara sfidës për të zhvilluar metodologji dhe mekanizma të përshtatshme për të mbuluar programe dhe institucione të huaja përveç atyre kombëtare, me qëllim për të rritur dobinë dhe për të kufizuar disavantazhet e mundshme të ndërkombëtarizimit të AL.

Udhëzimet e propozuara të OECD-UNESCO, rekomandojnë që agjencitë e SJC të garantojnë që proceset e tyre të sigurimit të cilësisë të përfshijnë edhe institucionet e huaja dhe private si dhe format e tjera të arsimit si edukimi në distancë dhe modele të tjera jotradicionale të arsimit. Megjithatë procesi i hartimit të udhëzimeve gjithashtu njeh se përfshirja e institucioneve të huaja në kuadrin e agjencive kombëtare do të kërkojë, në shumë raste, ndryshime në legjislacion dhe procedurat kombëtare e administrative.

Ky raport njeh rëndësinë dhe vështirësitë e ndërkombëtarizimit për SC në IAL. Edhe pse ai është trajtuar shumë më herët për përfshirjen e tyre si referencë në standardet Europiane të propozuara për SJC, propozimi për një Regjistër European përfshin qartë edhe agjencitë jashtë Europës që veprojnë këtu, sikurse dhe agjencitë Europiane që veprojnë jashtë kufijve Europianë.

Duhet pranuar gjithashtu se procesi i vazhdueshëm European, i përgjigjet plotësisht rekomandimeve të OECD-UNESCO-s, që agjencitë do të mbështesin dhe forcojnë rrjetet egzistuese rajonale dhe ndërkombëtare.

Rivlerësimet Ciklike të Agjencive

Fusha e SJC në AL në Europë është relativisht e re. Megjithatë, mund të konsiderohet një element i rritjes së maturisë së agjencive të cilat vitet e fundit kanë treguar interes në përmirësimin e besueshmërisë të punës së tyre duke u fokusuar në sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë të vetë agjencive. Një workshop i ENQA-s në Shkurt 2003 në Sitges, Spanjë, kishte si temë të saj sigurimin e cilësisë së agjencive. Pjesëmarrësit diskutuan mbi përvojat që egzistojnë në vlerësimin e jashtëm të agjencive dhe një nga përfundimet e workshop-it ishte rekomandimi që ENQA duhet të punojë drejt kryerjes së rivlerësimit ciklik të agjencive të SJC që janë anëtare të saj. Në përputhje me këtë, ENQA mori mandatin e Berlinit në kohën kur diskutimi për vlerësimin e jashtëm të agjencive tashmë kishte filluar në ENQA dhe ishte një nga çështjet në Mbledhjen e E4.

Ky raport rekomandon që çdo agjenci Europiane në intervale ciklike jo më

shumë se 5-vjet, duhet t'i nënshtrohet vlerësimit të jashtëm për proceset dhe aktivitetet e saj. Rezultatet duhet të jenë të dokumentuara në një raport i cili përcakton masën deri në të cilën agjencia është në përputhje me standardet Europiane për agjencitë e SJC (shih Kapitullin 2, Pjesa 3).

Në HEAL harta e siguriesve dhe organizmave që operojnë në SJC në AL padyshim do të jetë më e ndërlikuar në të ardhmen. Për këtë, është e rëndësishme që edhe ato agjenci që nuk janë antare të ENQA-s, të përfshihen në këtë hartë të agjencive të sigurimit të cilësisë. Akoma më e rëndësishme është që edhe agjencitë jo-europiane të kenë një mundësi të hapur në qoftë se duan të matin vetveten përkundrejt standardeve të rekomanduara Europiane. Prandaj, raporti nuk e kufizon fokusin e këtij rekomandimi vetëm për Agjencitë Europiane të njohura kombëtarisht, pra përfshirjen vetëm të anëtarëve aktualë ose potencialë të ENQA-s. Përkundrazi, agjencitë nga jashtë Europës, por që veprojnë në Europë, ose agjencitë Europiane që nuk janë të njohura në rang kombëtar, duhet gjithashtu të lejohen të zgjidhen për një vlerësim që mat shkallën e pajtueshmërisë së tyre me standardet Europiane.

Parimet e përgjithshme për vlerësimin ciklik propozohen të jenë si më poshtë:

- Agjencitë e SJC të themeluara dhe të njohura zyrtarisht si agjenci kombëtare nga një shtet nënshkrues i Bolonjës, duhet që normalisht të vlerësohen mbi baza kombëtare, duke respektuar kështu parimin e vullnetarizimit në qoftë se ato veprojnë edhe përtej kufijve kombëtarë. Këto agjenci kombëtare europiane, nga ana tjetër, mund të parapëlqejnë vlerësime të organizuara nga ENQA më tepër se sa vlerësimet e brendëshme mbi baza kombëtare. Vlerësimi i jashtëm i agjencive duhet të përfshijë një analizë edhe lidhur me atë nëse agjencitë janë në pajtim me standardet Europiane për Agjencitë e SJC.
- Agjencitë të themeluara dhe që nuk njihen zyrtarisht në një shtet nënshkrues të Bolonjës, mundet që me iniciativën e tyre të zgjedhin për t'u vlerësuar përkundrejt standardeve Europiane për Agjencitë e SJC.
- Vlerësimet e jashtme duhet të kryhet mbi bazën e një procesi që përfshin vetëvlerësimin, një panel të pavarur ekspertësh dhe një raport të publikuar.

Një vlerësim i jashtëm do të inicohet në mënyrë tipike në nivel agjencie ose në nivel kombëtar. Prandaj pritet që vlerësimet e agjencive zakonisht të ndjekin rregullat dhe kërkesat kombëtare ose nga proceset e vendosura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC) në vetë agjenci. Në këtë raport dëshirojmë të theksojmë rëndësinë e respektimit të parimit të vullnetarizimit. Për këtë arsye, ENQA, në respektim të anëtarëve të saj, do të marrë iniciativën ndaj një agjencie vetëm në rastin kur pas pesë vjetësh nuk është marrë asnjë iniciativë nga ana e vetë agjencisë. Në rastin kur agjencia nuk është anëtare e ENQA, dhe pas pesë vjetësh nuk është marrë asnjë iniciativë në nivel kombëtar ose nga vetë agjencia, Komiteti i Regjistrimit Europian është përgjegjës për të inicuar vlerësimin.

Kur iniciativën e vlerësimit e marrin autoritet kombëtare, qëllimi mund të jetë padyshim më i gjerë dhe mund të përfshijë përmbushjen e mandatit kombëtar nga agjencia etj. Megjithatë, për këtë propozim është thelbësore që vlerësimi, pavarësisht se nga kush është iniciuar, në nivel agjencie, në nivel kombëtar, apo nga ENQA, duhet gjithmonë të nxjerrë qartë se deri në ç'masë agjencia plotëson standardet Europiane për agjencitë e SJC. Asambleja e Përgjithshme e ENQA vendosi në mbledhjen e saj në Nëntor 2004 që, kriteri i anëtarësimit në ENQA, duhet të përputhet me standardet Europiane të propozuara për agjencitë e SJC. Në përputhje me këtë, vlerësimi i jashtëm i një agjencie do të evidentojë jo vetëm nivelin e përputhshmërisë me standardet Europiane, por në të njëjtën kohë edhe nivelin e pajtueshmërisë me kriterin e anëtarësimit në ENQA.

Së fundi, raporti thekson se përfshirja e ekspertëve ndërkombëtarë me përvojë dhe ekspertizë të përshtatshme do të sigurojë përfitime të konsiderueshme për procesin e vlerësimit.

Vazhdimësia e një vlerësimit ciklik do të jetë përgjegjësi kryesisht e autoriteteve që qëndrojnë mbi agjencitë, kombëtare ose jo, dhe natyrisht e vetë agjencive. ENQA do të ketë një rol në vazhdimësi vetëm në rastin e agjencive anëtare ku ENQA duhet të certifikojë shkallën me të cilën agjencia anëtare përputhet me standardet Europiane për agjencitë e SJC, duke u bazuar gjithmonë në vlerësimin e jashtëm. Rregullorja e ENQA-s do të specifikojë në vijim pasojat kur nuk jemi para një rasti të tillë.

Një shembull tregues për një proces model në një vlerësim të jashtëm të një agjencie tregohet në aneksin e këtij raporti.

Regjistri i Agjencive të Sigurimit të Jashtëm të Cilësisë që veprojnë në Europë

ENQA u angazhua përpara Takimit të Ministrave në Berlin 2003, për të hartuar në bashkëpunim me aktorët e interesuar, një regjistër European të agjencive të sigurimit të cilësisë, që përfshin agjencitë publike, private dhe tematike, që veprojnë ose që pritet të veprojnë në Europë.

Regjistri do u interesojë institucioneve të arsimit të lartë dhe qeverive sepse do të jetë në gjëndje të identifikojë agjencitë e sigurimit të cilësisë vepruese në Europë, që janë profesionale dhe të besueshme. Ky interesim, së pari bazohet në çështjen e ndërlikuar të njohjes së diplomave jo-kombëtare. Procedurat e njohjes së diplomave do të ishte më e konsoliduar nëse vetë ofruesit e tyre do të ofronin një cilësi të njohur nga agjencitë. Së dyti, gjithnjë e më shumë është e mundshme për institucionet e arsimit të lartë, ta kërkojnë sigurimin e cilësisë nga agjencitë jashtë kufijve nacionalë. Një regjistër i besueshëm i agjencive, do i ndihmonte sigurisht IAL për të identifikuar agjencitë që janë më të besueshme dhe profesionale.

Ndihma më e çmuar e këtij regjistri do të jetë vlera e tij informative për institucionet dhe aktorët e tjerë, dhe bërja e këtij regjistri në vetvete e një instrumenti shumë të dobishëm për arritjen e transparencës dhe krahasueshmërisë të sigurimit të jashtëm të cilësisë për IAL.

Regjistri duhet të bëjë të qartë nivelin e pajtueshmërisë të atyre që përfshihen në të, me standardet Europiane për agjencitë e sigurimit të jashtëm të cilësisë. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet që ky raport nuk synon të propozojë këtë regjistër si një instrument për renditjen e agjencive.

Regjistri duhet të jetë i hapur për aplikime nga të gjithë agjencitë që sigurojnë shërbimet brenda Europës, duke përfshirë edhe ato që veprojnë në vendet jashtë Europës ose ato transnacionale apo ndërkombëtare. Agjencitë do të vendosen brenda seksioneve të ndryshme të regjistrin në varësi të faktit nëse ato i janë nënshtruar ose jo një vlerësimi të jashtëm, nëse ato pajtohen ose jo me standardet Europiane për agjencitë e sigurimit të jashtëm të cilësisë dhe nëse ato veprojnë vetëm në shkallë kombëtare apo jashtë kufijve.

Një strukturë e mundshme për regjistrin është si më poshtë:

Seksioni 1. Agjencitë që e kanë kryer vlerësimin e jashtëm, të ndara sipas kategorive të mëposhtme:

- Agjencitë Europiane Kombëtare që janë vlerësuar dhe që plotësojnë të gjitha standardet Europiane për Agjencitë e SJC.
- Agjencitë Europiane Kombëtare që janë vlerësuar por që nuk plotësojnë të gjitha standardet Europiane për Agjencitë e SJC.
- Agjencitë Jo-Kombëtare dhe jashtë-Europiane që veprojnë në Europë, që janë vlerësuar dhe që plotësojnë të gjitha standardet Europiane për Agjencitë e SJC.
- Agjencitë Jo-Kombëtare dhe jashtë-Europiane që veprojnë në Europë, që janë vlerësuar, por që nuk plotësojnë të gjitha standardet Europiane për Agjencitë e SJC.

Seksioni 2. Agjencitë e pavlerësuara:

- Agjencitë Europiane Kombëtare, agjencitë jo-kombëtare, dhe agjencitë jashtë-Europiane që nuk janë vlerësuar dhe që, për këtë arsye vendosen të listuara sipas informacionit të mbledhur nga aplikimi dhe kërkesa e tyre për t'u përfshirë në regjistër.

Struktura e regjistrit është si më poshtë:

STRUKTURA E PROPOZUAR E REGJISTRIT	Të rishikuara		Të pavalësuara
	Pajtueshmëria me standartet Europiane	Papajtueshmëria me standartet Europiane	
Agjencitë Kombëtare Europiane	Operatorë Kombëtarë		
	Operatorë ndërkuftarë		
Agjencitë jo-kombëtare Europiane			
Agjencitë jashtë-Europiane që veprojnë në Europë			

Komiteti i Regjistrin Europian do të vendosë mbi pranimet në Regjistrin Europian. Komiteti do të mbështetet në pajtueshmërinë e agjencisë me standartet Europiane për agjencitë e sigurimit të jashtëm të cilësisë ashtu, ku, siç është identifikuar në vlerësimin ciklik, përbën një kriter për vendosjen në regjistër. Përveç këtij, duhet të formulohen edhe kritere të tjera, të cilat do të marrin parasysh diversitetin në sistemet e arsimit të lartë.

Komiteti do të jetë një strukturë e lehtë, jo-burokratike, me nëntë anëtarë të emëruar nga EURASHE, ESIB, EUA, ENQA dhe organizata të punëdhënësve, profesionale dhe bashkime të tjera si dhe përfaqësues qeveritarë. Këta anëtarë do të veprojnë si individë dhe jo si përfaqësues të mandatuar të emëruar nga organizatat nga vijinë. ENQA do të kryejë detyrat e sekretariatit për komitetin, i cili do të takohet të paktën dy herë në vit.

Komiteti i Regjistrin Europian do të zyrtarizojë si një prej detyrave të tij të para pronësinë mbi regjistrin.

Detyrë tjetër e menjëhershme për Komitetin e Regjistrin Europian do të jetë themelimi i një sistemi të pavarur dhe të besueshëm apelimi për të siguruar të drejtat për ata që janë refuzuar ose për ata që nuk janë pranuar për t'u përfshirë në regjistër. Ky sistem apelimi duhet të përbëjë një nga elementët e parashikuar në protokollin, që do hartohet nga komiteti menjëherë sapo ai do fillojë të veprojë.

Forumi Konsultativ European për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Deri në mbledhjen e Pragës në 2001, grupi E4, i përbërë nga ENQA, EUA, ESIB, EURASHE, është mbledhur rregullisht për të diskutuar pikëpamjet përkatëse për Procesin e Bolonjës dhe cilësinë në Arsimin e Lartë në Europë. Deri në mbledhjen e Berlinit në 2003, mbledhjet e E4 kanë pasur si fokus kryesor vënien në jetë të mandatit të Ministrave për SC në AL.

Ky bashkëpunim në nivel European ka rezultuar konstruktiv. Katër organizatat kanë rënë dakort që Forumi Konsultativ European për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë të vazhdojë të ekzistojë, i ndërtuar dhe mbështetur mbi grupin E4. Në aspektin praktik, themelimi i një forumi të tillë do të përforcojë bashkëpunimin aktual midis ENQA, EUA, ESIB dhe EURASHE mbi baza akoma më të qendrueshme. Forumi do të funksionojë fillimisht si një forum konsultativ dhe këshillimor për shumicën e aktorëve kyç Europeanë me marrëveshjen aktuale se këto katër organizata mbulojnë vetë shpenzimet e pjesëmarrjes së tyre në këtë forum, pa krijuar një strukturë të re administrative. Në një të ardhme, forumi do duhet të përfshijë në të edhe përfaqësues nga tregu i punës.

4. Perspektivat dhe Sfidat për të ardhmen

Ky raport përmban propozime dhe rekomandime që janë formuluar dhe nënshkruar nga aktorët kyç Europianë në sferën e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë. Vetë ekzistenca e Raportit është një dëshmi në arrijten e një mirëkuptimi të përbashkët në një fushë ku një kuptim i tillë është vështirë të arrihet për shkak të interesave të ndryshme që kanë palët e ndryshme në lojë. Propozimet ofrojnë rritje të transparencës, të sigurisë dhe informacionit rreth arsimit të lartë për studentët dhe shoqërinë në përgjithësi. Ato ofrojnë njohje të IAL-ve, besueshmëri, dhe një lloj mundësie e tyre për të treguar përkushtimin për një cilësi të lartë në kushtet e një konkurrence që vazhdimisht rritet dhe në një mjedis skeptik. Për agjencitë e SC, propozimet synojnë rritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së tyre dhe i lidh ato në një miqësi profesionale më të gjerë në rang Europian.

Por propozimet nuk do ta kalojnë kufirin e propozimeve nëse ato nuk do të shoqërohen me një strategji efektive për vënien e tyre në jetë. Nëse ato do të miratohen nga Ministrat në Bergen, pas kësaj do të ndërmerren hapa të menjëhershëm për të filluar futjen e disa elementëve kyç në këtë raport. Mesa duket, Regjistri i agjencive të SC do të fillojë gjatë dhe pas gjysmës së 2005 dhe do të jetë gati për të vazhduar më tej në 2006. Sekretariati i ENQA ka parashikuar burime shtesë që do të jenë të nevojshme për këtë qëllim. Pas takimit të Ministrave, ENQA do të ndërmarrë iniciativa konkrete, të nevojshme drejt themelimit të Komitetit të Regjistrimit Europian. Komiteti do fillojë punën e tij me zyrtarizimin e pronësisë së regjistrimit dhe hartimin e një protokollit të bazuar mbi një punë paraprake të bërë nga ENQA në pranverën e 2005. I pari vlerësim ciklik pritet të bëhet gjatë vitit 2005.

Forumi Konsultativ Europian për SC në AL do të jetë gjithashtu një iniciativë e afërt. Prandaj, rezultatet e mbledhjes së Ministrave në Bergen, dhe krijimi i forumit do të jenë tema kryesore në mbledhjen e ardhshme midis ENQA-s dhe partnerëve të saj E4 në Qershor 2005. Veç kësaj, bashkëpunimi në të ardhmen me aktorët e tjerë kyç si, përfaqësuesit e tregut të punës, do të jetë objekt i diskutimeve. ENQA gjithashtu ka organizuar një takim me rrjetet e tjera Europiane të SC para takimit tjetër të Asamblesë së Përgjithshme të ENQA-s në Shtator 2005.

Mundësia për vënien e shpejtë në jetë të disa propozimeve të këtij raporti nuk duhet të nënkuptojë që detyra për ato që kanë mbetur do të jetë e lehtë. Ajo do të

zgjase më shumë, në mënyrë që standardet e sigurimit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë të adoptohen gjerësisht nga institucionet dhe agjencitë, për shkak se pranimi i tyre do të varet edhe nga dëshira dhe gadishmëria për ndryshim dhe zhvillim edhe nga ana e shteteve nënshkruese që kanë tashmë sisteme të AL të fuqishme dhe me traditë të hershme. Ajo çka propozohet në standardet e Sigurimit të Brendshëm të Ciësisë do të jetë një sfidë për disa IAL, veçanërisht aty ku ka një traditë të re dhe në zhvillim të SC ose ku fokusi i nevojave të studentëve dhe përgatitja e tyre për të hyrë në tregun e punësimit nuk mbështetet në kulturën institucionale. Në mënyrë të ngjashme, standardet për SJC dhe për vetë agjencitë e SC do t'i detyrojnë të gjitha palët dhe veçanërisht agjencitë, të kërkojnë më shumë kujdes nga vetja dhe të çmojnë praktikën e tyre përkundrejt pritshmërisë Europiane. Procedura e re e vlerësimit ciklik do të sigurojë në kohë fokusimin në këtë qëllim. Kjo do të ndodhë vetëm kur të shihen përfitimet nga adoptimi i standardeve dhe ka të ngjarë që ato të pranohen gjerësisht prej tyre.

HEAL mbështet mbi përgjegjësitë individuale kombëtare për Arsimin e Lartë dhe kjo kërkon autonomi në çështjet e SJC. Për këtë arsye, ky raport nuk është dhe nuk mund të jetë i detyrueshëm, por vetëm sjell propozime dhe rekomandime në një frymë respekti të dyanshëm ndërmjet profesionistëve, ekspertëve të IAL-ve duke përfshirë edhe studentët, ministrive dhe agjencive të SC. Disa shtete nënshkruese mund të dëshirojnë të ruajnë standardet dhe procesin e vlerësimit brenda strukturave dhe kuadreve të tyre legjislativë ose administrative. Të tjerët mund të dëshirojnë të bëjnë një vlerësim më të gjatë të shkallës së përshtatshmërisë për zbatim të veprimeve, duke peshuar kështu avantazhet e ndryshimit përkundrejt pikave të forta të gjendjes aktuale. Forumi Konsultativ Europian për SC në AL duhet të bëhet një mjedis i dobishëm ku të diskutohet, debatohet dhe mësohet rreth mendimeve të reja, përvojave të sistemeve të tjera, si dhe ngjashmërive dhe ndryshimeve midis përvojave kombëtare.

Mbi të gjitha, kjo do të jetë një ngarkesë e konsiderueshme dhe sfiduese për ENQA-n, partnerët e saj të E4 dhe aktorët e tjerë kyç që do duhet të përballohet në vitet e ardhshme. Raporti bën gjithashtu të qartë se përmbushja e tij nuk do të thotë përmbushjen e synimeve të Bolonjës për një dimension Europian në fushën e SC në HEAL. Përpara ka ende shumë punë për të vënë në jetë rekomandimet e raportit dhe për të siguruar kulturën e kërkuar të cilësisë si në IAL ashtu dhe për vetë agjencitë e SJC. Ajo ç'ka është vënë tashmë në lëvizje nga mandati i Berlinit, ka nevojë për mirëmbajtje dhe përkujdesje të vazhdueshme nëse duam të sigurojmë funksionimin e plotë të dimensionit Europian për SC në HEAL.

Kështu bëhet i mundur krijimi i një Hapësirë Europiane të Arsimit të Lartë me IAL të fuqishme, autonome dhe efektive, një kuptim parësor i rëndësisë së cilësisë dhe standardeve, vlerësime të jashtme të mira e agjenci të besueshme të SC, një regjistër efektiv dhe një bashkëpunim në rritje me aktorët e tjerë kyç si: punëdhënësit, por propozimet që përmbahen në këtë raport do të bëjnë një rrugë të gjatë derisa ky vizion të bëhet realitet.

ANEKS:

Vlerësimi i Jashtëm Ciklik i Agjencie të Sigurimit të Cilësisë⁴ – një model teorik

Modeli i paraqitur më poshtë është një model tregues i propozuar për një proces vlerësimi të jashtëm të një Agjencie të SJC. Ai sillet si shembull i një procesi të besueshëm, të përshtatur për të identifikuar pajtueshmërinë me Standardet Europiane për Agjencitë e SJC. Megjithatë duhet shënuar që ai sillet vetëm me qëllim ilustrues dhe instruktiv. Për këtë arsye, ai është tepër i detajuar, madje më i detajuar se çka nevojitet për Agjencitë e SJC. Pra vetë ky shembull nuk duhet të konsiderohet si një standard. Për më tej duhet të vihet re që në shembullin e dhënë më poshtë termi vlerësim përdoret për të përshkruar objektivat dhe proceset. Në këtë kuptim mund të përdoren njëloj dhe termat “akreditim” ose “auditim”.

Procesi përfshin elementet e mëposhtëm:

- Formulimi i termave të referencës dhe protokollit për vlerësim;
- Emërimi dhe përcaktimi i panelit të ekspertëve;
- Vetëvlerësimi i kryer nga Agjencia;
- Vizitat në vend ;
- Raportimi.

1. Termat e referencës

Termet e referencës duhet të identifikojnë synimet e vlerësimit në kuptimin e perspektivave dhe interesave të autoriteteve, palëve të interesuara dhe të vetë agjencisë. Aty duhet të mbulohen të gjitha detyrat kryesore dhe veprimet e Agjencisë, dhe kjo duhet bërë në mënyrë të tillë që tregon qartë se nuk ka veprimtari të tjera të padukshme apo të fshehta.

2. Vetëvlerësimi

2.1 Informacioni bazë që kërkohet nga agjencia për vlerësim.

Informacioni bazë është i rëndësishëm dhe i nevojshëm për të kuptuar kontekstin në

të cilin punon agjencia.

Ky seksion pritet të përfshijë:

2. 1. 1 Një përshkrim të shkurtër të sistemit të arsimit të lartë kombëtar që përfshin:

- Strukturën e diplomave;
- Strukturën institucionale;
- Procedurat dhe palët e përfshira për ngritjen dhe hapjen e lëndëve, programeve dhe njësive të reja;
- Procedura të tjera të sigurimit të cilësisë;
- Statusin e institucioneve të arsimit të lartë në raport me qeverinë.

2. 1. 2 Një raport të shkurtër mbi historinë e agjencisë në fjalë dhe vlerësimin e Arsimit të Lartë në përgjithësi:

- formulimi i misionit;
- themelimi i agjencisë (qeveri, institucionet e AL, tjetër);
- përshkrimi i kuadrit ligjor dhe rregullimet e tjera zyrtare që kanë të bëjnë me agjencinë (psh: ligjet, VKM, urdhrat, dekretet);
- financimi i agjencisë;
- vendosja e të drejtës për të filluar vlerësimet;
- organizimi i brendshëm i agjencisë; duke përfshirë procedurat e punës dhe përbërjes së bordit/këshillit;
- përgjegjësi të tjera të agjencisë përveç vlerësimit të AL;
- veprimtaria ndërkombëtare e agjencisë, duke përfshirë marrëveshjet zyrtare si dhe aktivitete të tjera psh: pjesëmarrja në konferenca, grupe pune dhe shkëmbim stafi;
- roli i agjencisë në proceset e vazhdimësisë pas vlerësimit; pasojat dhe sanksionet.

2. 2 Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë që kryen agjencia

Duhet të tregohet qartë se agjencia në fjalë ndërmerr mbi baza të rregullta sigurimin e jashtëm të cilësisë të programeve apo institucioneve të Arsimit të Lartë. Ky proces duhet të përfshijë vlerësimin, akreditimin, rivlerësimin, auditimin, të cilat duhet të jenë pjesë e funksioneve thelbësore të agjencisë.

Me fjalën 'rregullisht' kuptohet që vlerësimet planifikohen në mënyrë të rregullt, mbështetur mbi një procedure sistematike dhe disa prej vlerësimeve duhet të jenë kryer të paktën gjatë dy viteve të fundit.

Kjo duhet të përfshijë:

- një përshkrim të kuadrit metodologjik të agjencisë
- një raport mbi numrin e vlerësimeve të cilësisë të kryera dhe të numrit të njëjësive të vlerësuara

2.3 Metoda e vlerësimit e ndjekur nga agjencia

2.3.1 Informacioni bazë

Një raport mbi planin e plotë të një vlerësimi dhe çështje të tjera kryesore që duhen përcaktuar, nëse agjencia po punon mbështetur mbi një procedurë metodologjike transparente.

Ky raport duhet të përfshijë:

- procedurat për udhëzimin dhe komunikimin me institucionet nën vlerësim;
- strategjia e agjencisë për pjesëmarrjen e studentëve;
- procedurat në lidhje me termat konkretë të references/planprojektit që ka të bëjë me vlerësimin individual;
- Referencën(-at) për vlerësimin (kriteret e paracaktuara, dokumentat ligjorë, kërkesat e lëndëve, standardet profesionale, qëllimet e shpallura të institucionit në vlerësim);
- masën në të cilën elementët metodologjikë modifikohen për vlerësimin konkret.

2.3.2 Elementet e metodologjisë

Një raport që dëshmon se metodologjia e paracaktuar dhe e shpallur e agjencisë funksionon dhe se rezultatet e rivlerësimit bëhen publike.

Metodologjia përfshin:

- vetëvlerësimin ose procedurën ekuivalente të objektit në vlerësim;
- vlerësimin e jashtëm nga një grup ekspertësh dhe vizitat në vend, ashtu siç janë të vendosur më parë nga agjencia;
- publikimi i një raporti me rezultate publike.

Agjencia mund të përpunojë dhe të aplikojë edhe metodologji të tjera të përshtatura për qëllime të veçanta.

Vendimet dhe raportet e agjencisë janë në pajtim me parimet dhe kërkesat edhe nëse formulimet hartohen nga grupe të ndryshme.

Nëqoftëse agjencia merr vendime pas vlerësimit, duhet të ketë një sistem apelimi. Kjo metodologji aplikohet sipas nevojave të agjencisë.

Nëqoftëse agjencia nxjerr rekomandime dhe/ose vendime me kusht, ajo duhet të ketë një plan dhe procedurë të vazhdimësisë për të kontrolluar këto rezultate.

2.3.3 Një raport mbi rolin të grupit të ekspertëve të jashtëm

Raporti mbi rolin e grupit të jashtëm të ekspertëve duhet të përfshijë:

- procedurën për emërimin dhe caktimin e ekspertëve, duke përfshirë kriteret për angazhimin e ekspertëve ndërkombëtarë dhe përfaqësues të palëve të interesuara si punëdhënësit dhe studentët;
- metodat për udhëzimin dhe trainimin e ekspertëve;
- takimet midis ekspertëve: numri, qëllimet, programi në lidhje me zhvillimin e të gjithë procesit të vlerësimit;
- ndarja e punëve midis agjencisë dhe ekspertëve;
- roli i stafit të agjencisë në vlerësim;
- identifikimi dhe caktimi i anëtarëve të stafit të agjencisë përgjegjës për vlerësimin

2.3.4 Dokumentacioni

Nevojiten një sërë të dhënash për procedurat e agjencisë për mbledhjen e dokumentacionit për vetëvlerësimin e agjencisë dhe vizitat në vend:

2.3.4.1 Një raport për procedurat që lidhen me vetëvlerësimin

Ky raport duhet të përfshijë:

- specifikime të përmbajtjes në udhëzimet që jepen nga agjencia;
- këshillat procedurale që jepen nga agjencia;
- kërkesat për përbërjen e grupeve të vetëvlerësimit, përfshirë edhe rolin e studentëve;
- informimin/trainimin për grupet e vetëvlerësimit;
- kohën në dispozicion për kryerjen e vetëvlerësimit.

2.3.4.2 Një raport për procedurat që lidhen me vizitën në vend

Ky raport duhet të përfshijë:

- protokollet e pyetësorëve/intervistave;
- parimet për përzgjedhjen e pjesëmarrësve/të informuarve (kategoritë dhe pjesëmarrësit e veçantë);
- parimet për kohëzgjatjen e vizitës;
- numri i takimeve dhe kohëzgjatja mesatare e tyre;
- dokumentacioni i takimeve (të brendshme/të jashtme, shënimet, transkriptimet etj);
- metodat e punës të grupit të ekspertëve të jashtëm.

2.3.4.3 Raportet

Dokumentacioni duhet të përfshijë informacionin e dhënë më poshtë për raportet:

- qëllimi i raportit;
- draftimi i raportit (stafi i agjencisë apo ekspertët);

- formati i raportit (kompozimi dhe vëllimi);
- përmbajtja e raportit (dokumentacion apo vetëm analiza/rekomandime);
- parimet për marrjen e feedback-ut nga palët e vlerësuara në draft-raport;
- politikat dhe procedurat e publikimit dhe (psh: menaxhimi në lidhje me mediat);
- vazhdimësia afatshkurtër (psh: seminare dhe konferenca);
- aktivitete afatgjata të vazhdimësisë (psh vlerësimi vazhdues ose vizita).

2.3.5 Sistemi i apelimit

Agjencia duhet të sjellë në mënyrë të dokumentuar një metodë për apelimin kundër vendimeve të saj dhe mënyrën se si kjo metodologji aplikohet sipas nevojave të agjencisë. Duhet të bëhet e qartë nga dokumentacioni se deri në ç'masë sistemi i apelimit i jep mundësi palëve të dëgjohen, që t'u sigurojë atyre që vlerësohen, një mjet për të pyetur dhe komentuar mbi rezultatet e vlerësimit.

Agjencia duhet të sigurojë të dhëna bazë që sistemi i sigurimit i ngritur prej saj, garanton për ata që vlerësohen, një mundësi për të shprehur opinionet e tyre për rezultatet e vlerësimit.

2.4 Dokumentacion shtesë

Ky dokumentacion duhet të sigurojë një përmbledhje mbi përdorimin e vëzhgimeve, të dhënave statistikore ose llojeve të tjera të dokumentacionit që nuk janë përmendur tjetërkund. Ky material duhet të bëhet publik.

2.5 Procedurat për një Sistem të Cilësisë për agjencitë

Agjencia duhet të dokumentojë se ka vendosur mekanizma për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC) e që pajtohen me ato të përcaktuara në standardet Europiane për agjencitë e SJC.

2.6 Reflektime përfundimtare

Eshtë e nevojshme të bëhet një analizë e pikave të forta, pikave të dobëta, mundësive dhe kërcënimeve për Agjencinë, në mënyrë që të jepet një raport mbi kapacitetet që ka agjencia për t'ju përshtatur kërkesave dhe prirjeve të reja dhe për të përmirësuar në vijimësi veprimtarinë e saj, ndërkohë që siguron edhe një sistem metodologjik e një model administrimi e drejtimi të besueshëm dhe të qëndrueshëm.

3. Udhëzime për Panelin e Jashtëm të Vlerësimit

Këto udhëzime përshkruajnë se çfarë pritet nga Grupi i Jashtëm i Vlerësimit. Këto përfshijnë udhëzime mbi:

- përcaktimin e përbërjes dhe organizimin e përgjithshëm;
- vizitën në vend;
- draftimin e raportit.

Ashtu si është përshkruar më lart, agjencia nën vlerësim duhet të përgatisë një raport vetëvlerësimi sipas udhëzimeve të dhëna. Raporti i vetëvlerësimi duhet t'i dërgohet Grupit të Vlerësimit të Jashtëm jo më vonë se një muaj përpara vizitës së tyre.

3.1 Caktimi i Panelit të Vlerësimit të Jashtëm

Ky seksion ka të bëjë me caktimin e ekspertëve që do të kryejnë vlerësimin.

Grupi i Ekspertëve të Jashtëm duhet të përbëhet nga ekspertët e mëposhtëm:

- një ose dy ekspertë të sigurimit të cilësisë (ndërkombëtarë);
- përfaqësues të IAL-ve (kombëtarë);
- përfaqësues nga studentët (kombëtarë);
- anëtar nga palë të interesuara (për shembull: punëdhënës, kombëtarë).

Një nga këta ekspertë duhet të zgjidhet kryetar i Panelit të Vlerësimit të Jashtëm.

Gjithashtu rekomandohet që grupi të plotësohet me një person i cili është i pavarur nga agjencia dhe që do të veprojë në rolin e sekretarit të grupit.

Emërimi i ekspertëve mund të vijë nga agjencitë, palët e interesuara ose autoritete lokale, por të tillë që të mund të sigurojnë një vlerësim të besueshëm dhe të vërtetë; është e rëndësishme që detyra e përcaktimit të ekspertëve t'i jepet një palë të tretë jashtë agjencisë së përfshirë në proces. Kjo palë e tretë mund të jetë psh, ENQA ose një agjenci jo e përfshirë në proces. Bazat për miratimin e ekspertëve duhet të jenë deklaratat për pavarësinë e tyre. Gjithsesi agjencisë që vlerësohet duhet t'i jepet mundësia të bëjë vërejtje e komente mbi përbërjen përfundimtare të grupit.

3.2 Vizita në vend

Atyre që kryejnë vizitën në vend duhet t'u vihet në dispozicion një protokoll i cili duhet të jetë sipas udhëzimeve më poshtë:

Vizita rekomandohet të ketë një kohëzgjatje prej 2-3 ditësh duke përfshirë përgatitjet dhe procesin vazhdues, në varësi të faktit se sa njohje dhe të dhëna kanë marrë paraprakisht ekspertët për agjencinë në proces dhe në varësi të kontekstit të vlerësimit. Një ditë para vizitës, grupi duhet të takohet për të përcaktuar dhe rënë dakort për temat e mundshme të vizitës. Synimi i vizitës në vend është të vërtetojë

vlefshmërinë e raportit të vetëvlerësimit. Intervistimet gjatë kësaj vizite udhëzohen e hartohen duke mbajtur parasysh këtë perspektivë.

Vizita mund të përfshijë takime të veçanta me anëtarë të bordit të Agjencisë, administratën, stafin, ekspertët, aktorët kyç/kryesorë dhe përfaqësues nga institucionet (njësitë) e vlerësuara në nivel administrativ si dhe anëtarë nga Grupet e Brendshme të Vetëvlerësimit.

3.3 Përgatitja e Raportit

Përveç plotësimit të termave të përgjithshme të referencës, raporti duhet të fokusohet në një mënyrë të kujdesshme në pajtimin me standardet Europiane për Agjencitë e Sigurimit të Jashtëm të Cilësisë, ashtu si veçohet në protokollin e vetëvlerësimit, si dhe në mundësitë dhe rekomandimet për përmirësime në të ardhmen.

Pas vizitës, Paneli i Vlerësimit të Jashtëm, i ndihmuar nga sekretaria, harton raportin. Versioni përfundimtar i tij duhet t'i dërgohet agjencisë nën vlerësim për të bërë komente mbi gabime të faktuara.

¹ Asambleja e përgjithshme e ENQA shpalli në 4 nëntor 2004, ndryshimin e Rrjetit Europian të mëparshëm në Shoqatën Europiane.

² Termi “Sigurimi i Cilësisë” në këtë raport përfshin procese si vlerësim, akreditim dhe auditim.

³ Në të gjithë raportin termi kombëtar përfshin edhe kontekstin rajonal në lidhje me Agjencitë e Sigurimit të Cilësisë, kontekstet dhe autoritetet kombëtare etj.

⁴ Struktura e këtij aneksi është e ngjashme me atë të një manuali të dokumentuar kohët e fundit në një projekt për njohjen reciproke të agjencive të sigurimit të cilësisë në vendet Nordike.